



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute Public Health of Kosova

RAPORTI VJETOR 2024

INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS

Prishtinë, Janar 2025

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	1
2. Progresi me planin e punës – rezultatet kyçe	5
2.1 Departamenti i Epidemiologjisë	5
2.1.1 Sëmundjet ngjitëse	5
2.1.2 HIV/AIDS/IST	7
2.1.3 Vaksinimi	7
2.1.4 Kontrolla sanitare dhe infeksione brendaspiatore	8
2.1.5 Aktivitete tjera	8
2.1.6 Pjesëmarrja në grupe punuese, punëtori, trajnime, konferenca, vizita studimore për ngritje të kapaciteve profesionale:	9
2.2. Departamenti i Ekologjisë Humane	10
2.2.1 Qendra e ujit	11
2.2.2 Cilësia e ujit për pije gjatë rritjes së vlerave të Manganit në burimin e ujit “Badoc”	11
2.2.3 Cilësia e ujit për pije pas ngjarjes në kanalin e Ibër Lepencit	12
2.2.4 Mbikëqyrja e kushteve higjieniko - sanitare	12
2.2.5 Aktivitete tjera	12
2.2.6 Pjesëmarrje në trajnime dhe punëtori	12
2.3. Departamenti i Mikrobiologjisë	13
2.3.1 Shërbimet mikrobiologjike	13
2.3.2 Ngritje e kapaciteve laboratorike	14
2.3.4 Zhvillimi i sistemit për menaxhimin e cilësisë në laborator	14
2.3.5 Zhvillimi i udhërrëfyesve dhe politikave shëndetësore	15
2.4 Departamenti i Mjekësisë Sociale	15
2.4.1 Observatori për shëndetin e nënës, fëmijës dhe të rinjve	15
2.4.2 Promovimi dhe Edukimi Shëndetësor	16
2.4.3 Aktivitetet tjera	16
2.4.4 Trajnimet dhe takimet	17
2.5 Qendra e Laboratoreve Testuese	18
2.5.1 Monitorimi i cilësisë së ujit	18
2.5.2 Monitorimi i cilësisë së ushqimit:	19
2.5.3 Monitorimi i ambientit të brendshëm	19
2.5.4 Aktivitete tjera	19
2.6 Departamenti i Statistikave Shëndetësore	20
2.6.1 Vjetarët statistikor për vitin 2023	20
2.6.2 Aktivitet tjera:	21
2.6.3 Përgatitja e të dhënave sipas kërkesës nga MSH/institucionet tjera	22
2.7 Departamenti i Buxhetit dhe Financave	23

2.8	Departamenti i Administratës	24
2.8.1	Të përgjithshme	24
2.8.2	Logjistika/depo	24
2.8.3	Teknologjia informative	25
2.8.4	Divizioni i Personelit	25
2.9	Divizioni i Prokurimit	26
2.10	Qendra për Udhërrëfyes dhe Protokole Klinike, Performancën e sistemit Shëndetësor dhe Satisfakcionin e Pacientëve	27
2.11	Qendra e Moshimit	28
2.11.1	Moshimi	28
2.11.2	Aktivitete tjera	29
2.12	Komunikimi me publikun	29
2.13	Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik	30
2.14	Aktivitete tjera	30
3.	Sfidat në realizimin e detyrave	31
4.	Planet për vitin e ardhshëm	32

Shkurtesat

AMC	Aksioni për nëna dhe fëmijë
AQH	Kujdesi Shëndetësor Cilësor dhe i Qasshëm
AQP	Autoriteti Qendror i Prokurimit
ASK	Agjencia e Statistivave të Kosovës
AUV	Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
CDC	Qendra për kontrollën e sëmundjeve ngjitëse
DE	Departamenti i Epidemiologjisë
ECDC	Qendra Evropiane për Kontrollën e Sëmundjeve Ngjitëse
ELDSNet	Rrjeti Evropian i Mbikëqyrjes së Sëmundjes së Legjionelës
ELISA	Analiza Imunosorbente e Lidhur me Enzimën
EMCDDA	Qendra Monitoruese Evropiane për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave
EUDA	Agjencia e Bashkimit Evropian për Drogat
HPV	Virusi i Papillomës Humane
IEAAP	Instituconet Edukative, Arsimore, Aftësuese të arsimit Parauniversitar
IUHPE	Unioni Ndërkombëtar për Promovim dhe Edukim Shëndetësor
IHS	Shërbimet Shëndetësore të Integruara
IHR	Rregullorja Ndërkombëtare e Shëndetit
IKShPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
IST	Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme
KHS	Kushtet higjieniko-sanitare
KKK	Kryqi i Kuq i Kosovës
KOPF	Fondacioni Kosovar për Popullsi
KPKI	Komiteti Profesional për Këshillim për Imunizim
KPSH	Kujdesi Parësor Shëndetësor
KRU	Kompanija Rajonale e Ujësjellësit
MCDDA	Qendra e Monitorimit të Drogave dhe Varësisë nga Droga
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetit
OJQ	Organizatë joqeveritare
OMK	Oda e Mjekëve të Kosovës
PSO	Procedura Standarde Operative
RT-PCR	Reaksioni zinxhiror i polimerazës së transkriptimit të kundërt
QKTGJK	Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut e Kosovës
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QOESHP	Qendra Operative Emergjente e Shëndetit Publik
QRSH	Qendra Rajonale e Shëndetësisë Publike
PSO	Procedura Standarde të Operimit
SECID	Qendra Juglindore për Kontrollën e Sëmundjeve Ngjitëse
SMSN	Sistemi i Menaxhimit të Sëmundjeve Ngjitëse

SP	Spital i Përgjithshëm
SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
SISH	Sistemi Informativ Shëndetësor
TDI	Treguesit të Kërkesës për Trajtim për Drogë ose Alkool
TESSy	Sistemi Evropian i Mbikëqyrjes (së sëmundjeve ngjitëse)
UA	Udhëzim Administrativ
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsi
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për fëmijë
UNV	Vullnetarët e Kombeve të Bashkuara
UPK	Udhërrëfyesit dhe Protokolet Klinike
ZF	Zona e Furnizimit

1. Përmbledhje ekzekutive

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) gjatë vitit 2024 është angazhuar në zbatimin e ligjeve dhe kryerjen e veprimtarisë profesionale, mbi bazën e barazisë, përgjegjshmërisë, të dhënave shkencore dhe analizave profesionale. Me qëllim të lehtësimit të funksionimit të brendshëm të IKSHPK, është miratuar Statuti i IKSHPK-së si dhe Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IKSHPK.

Departamenti i Epidemiologjisë ka vazhduar mbikëqyrjen e situatës epidemiologjike duke kryer hulumtimin e rasteve, grumbullimin, analizën dhe raportimin e të dhënave epidemiologjike me rekomandime përkatëse, si dhe në bashkëpunim me institucione vendore dhe ndërkombëtare të shëndetit publik. Deri më 31.12.2024 janë raportuar 277,616 raste të sëmundjeve ngjitëse me incidencë 15,577.9/100,000 banorë, që është numër më i lartë në krahasim me vitin 2023. Më së shumti raste të raportuara janë Sëmundja e ngjashme me gripin (ILI) me 138,825 raste ose incidencë 7,789.9/100,000 banorë dhe kjo paraqet rritje në krahasim me vitin 2023 (129,315 raste). Janë raportuar 1,732 raste me COVID-19 që është numër më i ultë se në vitin 2023 (2,153 raste) ndërsa raste të importuara të sëmundjeve ngjitëse janë: 4 malarie, 1 Lija M dhe 1 morbill. Gjatë vitit 2024 janë raportuar 34 raste të reja me HIV, që paraqet rritje në krahasim me vitin 2023 (20 raste). Është bërë raportimi i rasteve të West Nile Virus në Tessy, Raportimi në IHR dhe ELDSNet i rastit human me infektion të Legionellës, dhe i rastit të Lijës M sipas IHR në OBSH, lidhur me udhëtime jashtë vendit. Me qëllim të komunikimit dhe informimit sa më të mirë të publikut, prej funksionalizimit të ueb faqes së re të IKSHPK-së janë publikuar buletinët dhe analizat e ndryshme epidemiologjike dhe janë të qasshme për të gjithë.

Sa i përket vaksinimit, është përditësuar dhe shpërndarë Kalendar i rregullt i vaksinimit duke implementuar edhe tre vaksinat vaksina te reja (Rota, Pneumo dhe HPV), ndërsa ka vazhduar vaksinimi sipas indikacioneve epidemiologjike dhe të trafikut ndërkombëtarë, si dhe përkujdesja për Zingjirin e flohtë. Mbulueshmëria me vaksinim sipas Kalendarit të rregullt për vitin 2024, në nivel vendi është 87% (duke llogaritur DTaP1 – 95%, DTaP3 – 78 % dhe MMR1 - 88 %). Ndryshimet në kalendarin e rregullt të vaksinimit me përfshirjen e tri vaksinave te reja përgjatë viteve 2023- 2024 kanë rezultuar me përqindje më të ulët të mbulueshmërisë duke qenë se DTaP3 është spostuar nga muaj i katërt në muajn e gjashtë. Janë vaksinuar rreth 10,000 vajza të moshës 12 vjeç kundër HPV. Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2024/2025 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale dhe nga 30 shtatori deri në fund të vitit 2024 janë administruar 64,011 doza. Komiteti Profesional për Këshillim dhe Imunizim ka dhënë rekomandime për përfshirjen e djemve në vaksinimin HPV, për sigurimin e dozave për vaksinën kundër Lijës M dhe për vaksinimin vullnetar të vajzave deri në moshën 21 vjeç. Është zhvilluar edhe vaksinimi plotësues dhe fushata "derë me derë" për identifikimin dhe vaksinimin e fëmijëve të pavaksinuar, veçanërisht në komunitetet vulnerabël si ato Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Sa i përket mbikëqyrjes sanitare, nga gjithsejt 42,387 vizita sanitare të kryera në nivel vendi gjatë këtij viti, 1,696 ose 4.0% e rasteve kanë rezultuar pozitive. Më së shumti raste pozitive janë regjistruar në QRSHP Prizren, 478 nga 6,644 vizita (7.19%). Nga bakteriet patogjene *Staphylococcus aureus* është izoluar më së shpeshti dhe ate në 1,382 raste (81.4%), ndërsa nga parazitët prinë *Giardia lamblia* e izoluar në 236 raste (13.9%).

Departamenti i Ekologjisë Humane gjatë vitit 2024 ka realizuar detyrat e parapara me planin vjetor të punës, duke bërë Monitorimin e cilësisë dhe sigurisë të ujit për konsum human; Vlerësimin e kushteve higjieniko-sanitare në Instituconet Edukative, Arsimore, Aftësuese të arsimit Parauniversitar (IEAAP), shëndetësore dhe hoteliere; dhe Aktivitete tjera që ndërlidhen me fushëveprimin e departamentit.

Sa i përket mbikëqyrjes rutinore të ujit të pijshëm, gjithsej janë analizuar 11,631 mostra të ujit prej të cilave 97.66% janë në përputhshmëri me vlerat parametrike të Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2021 “Për Cilësinë e Ujit të destinuar për konsum nga njeriu”. Përpos mbikëqyrjes rutinore, janë menaxhuar edhe situatat emergjente: 1) ri-paraqitja e fenomenit të Manganit në Liqenin e Badocit. Në vitin 2024 vlerat e shtuara të manganit u shoqëruar me kohëzgjatje prej 44 ditë andaj, për këtë periudhë janë marrë 455 mostra të ujit prej të cilave 79.56% kanë rezultuar me vlera të rritura të manganit, gjegjësisht mbi 0.05 mg/L, 2) Pas shpërthimit në kanalin Ibër-Lepenc ekipet e IKSHPK dhe QRSHP janë mobilizuar dhe kanë përcjellur situatën e furnizimit nga rrjeti shpërndarës i KRU”Mitrovica” dhe KRU”Prishtina”. Janë marrë 100 mostra të ujit për analiza fiziko-kimike, 100 për analiza bakteriologjike si dhe 13 mostra për analiza në metale të rënda (në ujin e pa trajtuar dhe ujin nga rrjeti shpërndarës).

Është bërë edhe vlerësimi i kushteve higjieniko-sanitare në 51 shkolla dhe 14 çerdhe (publike dhe private) prej të cilave vetëm 59.46% e shkollave dhe 64.29% e çerdheve kanë rezultuar me vlerësim të kënaqshëm.

Departamenti i Mikrobiologjisë gjatë vitit 2024 ka kryer gjithsej gjithsej 288,231 ekzaminime mikrobiologjike, prej tyre 169,607 në IKSHPK ndërsa 118,624 në të gjitha QRSHP-të bashkë. Në IKSHPK janë bërë 37,556 teste serologjike me ELISA për detektim të antitropave /antigjeneve ndaj/të patogjenëve të ndryshëm infektiv, dhe është i vetmi institucion që kryen këtë shërbim diagnostik për sëmundje infektive. Në QRSHP-të numri më i madh i mostrave ishte urogenitale dhe respiratore.

Gjatë vitit 2024 është bërë shtrirja e Sistemit digjital të Informacionit Laboratorik “Medlis”, për regjistrimin e mostrave nëpërmjet rrjetit qeveritar, i cili funksionon në të gjitha objektet e IKSHPK, përpos në Mitrovicë. Ka filluar shërbimi i testimit të moshave të reja (fëmijëve) nëpërmjet fecesit për diagnostikimin e tuberkulozit me Genexpert. Po ashtu janë zhvilluar aktivitete lidhur me sekvencionimin e mostrave të përzgjedhura për Sars Cov-2, virusit të influencës, HIV dhe Mycobacterium Tuberculosis.

Është punuar në drejtim të zhvillimit të sistemit për menaxhimin e kualitetit në laborator me qëllim të përgatitjes së Departamentit për hyrje në proces të akreditimit.

Departamenti i Mjekësisë Sociale ka kryer aktivitetet të cilat lidhen me shëndetin e nënës, fëmijës dhe të rinjve, promovimin dhe edukimin shëndetësor të popullates, si dhe me mbikëqyrjen e planeve të veprimit të cilat ndërlidhen me promovim dhe edukim shëndetësor. Janë zhvilluar 11 fushata me 62,750 pjesëmarrës: Java e kancerit të qafës së mitrës, Dita Botërore e tuberkulozit, Dita Botërore e Shëndetit, Dita Botërore kundër Duhanit, Dita Botërore e Hipertensionit, Muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, Dita Botërore kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Drogave, Dita Botërore e Zemrës, Dita Botërore e Diabetit, Dita Botërore e HIV/AIDS, dhe dita e Personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë përcjellë me hartim, përgatitje/miratim dhe distribuimi i 96,707 materialeve të informimit, edukimit dhe komunikimit shëndetësor. Janë zhvilluar 76 trajnime me 1,727 pjesëmarrës dhe 921 ligjërata me 67,378 pjesëmarrës për tema të ndryshme të edukimit dhe promovimit shëndetësor.

Qendra e Laboratoreve Tesuese (QLT) gjatë vitit 2024 ka realizuar aktivitete në monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm (urban, rural, të ambalazhuar), ujit të pishinave, ushqimit, mjedisit të brendshëm, si dhe ka kryer aktivitete tjera për fuqizim të kapaciteteve profesionale. Janë analizuar 4,586 mostra të ujit në laboratorë të ndryshëm të QLT -së, është bërë përcjellja dhe monitorimi i prezencës së toksinave kimike dhe mikrobiologjike, aditiveve, metaleve të rënda, dhe mykotoksinave, në ushqim, si dhe i trihalometanit, karbonit total organik, metaleve të rënda dhe mineraleve në ujërat e pijshëm dhe rekreativ. Sa i përket mjedisit të brendshëm, janë analizuar 88 parametra (dioksidi i azotit, formaldehidet, benzeni, monoksidi i karbonit, dioksidi i karbonit, temperatura, lagështia relative dhe materjet grimcore PM_{2.5}) në institucionet publike parashkollore në komunën e Prishtinës.

Departamenti i Statistikave Shëndetësore në IKSHPK për periudhën Janar-Dhjetor 2024 ka vazhduar me aktivitetet rreth grumbullimit dhe përpunimit të statistikave shëndetësore nga institucionet publike dhe disa institucione private në Kosovë, dhe si rezultat janë përfunduar 14 Vjetarë statistikor për vitin 2023. Po ashtu, janë bërë raporte specifike me kërkesë të MSh-së ose institucioneve tjera.

Buxheti për IKSHPK për vitin 2024 ka qenë 5,253,120 Euro, ndërsa realizimi ka qenë 94.99%. Gjatë kësaj periudhe, vërejmë rritje të të hyrave vetanake kryesisht nga kontrolla higjieniko-sanitare 911,414,49 Euro në krahasim me 887,634,51 Euro në 2023. Janë blerë 10 vetura nga projekti kapital i realizuar përmes Buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Burimet njerëzore gjatë vitit 2024 janë pasuruar me dy (2) Mjek Specialist, shtatë (7) Infermierë/laborantë dhe tre (3) Pastrues. Shtatë (7) punëtorë janë pensionuar. Katër (4) punëtorë janë në pushim të lehonisë në vitin 2024, dhe dy vazhdojnë pushimin në vitin 2025. Numri gjithsej i pozitave të lejuara për vitin 2024 ka qenë 306.

Divizioni i prokurimit në IKSHPK në vitin 2024 ka zhvilluar 24 aktivitetet të prokurimit, prej tyre 22 aktivitete janë realizuar ndërsa 2 janë në pritje të vendimit nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Qendra për Udhërrëfyes dhe Protokole Klinike, Performancën e sistemit shëndetësor dhe Satisfakcionin e Pacientëve ka facilituar procesin e adaptimit të Udhërrëfyesve Klinikë dhe hartimit të Protokoleve Klinike, si komponentë e rëndësishme për standardizimin e kujdesit shëndetësor, përmirësimin e rezultateve të pacientit, sigurinë në kujdesin shëndetësor dhe përgjegjësinë ligjore dhe etike në kujdesin shëndetësor. Sekretaria e themeluar me vendimin e Ministrit më 25.01.2024 ka asistuar në 63 Udhërrëfyes Klinikë dhe 8 Protokole Klinike.

Qendra e moshimit gjatë vitit 2024 ka kryer aktivitete për shëndetin e të moshuarve në Kosovë përmes avokimit, trajnimeve, hulumtimeve, krjimit dhe shpërndarjes së materialit promovues shëndetësor, etj. Në mesin e tyre, vlen të theksohet trajnimi i personelit të kujdesit shëndetësor (infermierë) për edukimin dhe trajnimin e kujdestarëve informalë në kujdesin në shtëpi të të moshuarve; grupi punues për plotësim të programit specialistik për mjekësi familjare me modulën kujdesi ndaj personave të moshuar dhe kujdesi paliativ; si dhe koordinimi i hulumtimit "Zbulimi i nevojave të paplotësuara të kujdesit shëndetësor në mesin e të moshuarve në Prishtinë" në të gjitha Qendrat për persona të moshuar në komunën e Prishtinës.

Komunikimi me publikun dhe rritja e transparencës kanë pasur rëndësi të veçantë gjatë vitit 2024. Është përditësuar ueb faqja e IKSHPK-së, me 106 materiale që mbulojnë tema të ndryshme shëndetësore dhe informuese. Në faqjen e IKSHPK-së në rrjetin social Facebook janë bërë 20 komunikata, 202 postime, 6 infografika dhe 6 video mesazhe për të informuar dhe sensibilizuar publikun për çështje të rëndësishme shëndetësore. Janë dhënë 383 përgjigje për mediat dhe janë realizuar 33 intervista në media. Nuk ka pasur kërkesa për qasje në dokumente publike për vitin 2024.

Tjera: IKSHPK ka vazhduar aktivitetin arsimor, me studime paradiplomike dhe pasdiplomike, ndërsa stafi jonë ka kontribuar që të ri-akreditohet programi i doktoratës në Shëndetësi Publike. Po ashtu, 2 epidemiologë dhe 1 specialist i shëndetësisë publike kanë marrë përgjegjësi të Dekanit dhe Prodekanit në Fakultetin e Mjekësisë gjegjësisht Prorektorit për çështje arsimore në Universitetin e Prishtinës.

Është rifreskuar autoparku edhe me 5 vetura të marrura në përdorim, që kontribuon në veçanti në mbikëqyrjen epidemiologjike dhe mikrobiologjike në terren, si dhe në sigurinë e të punësuarve gjatë punës në terren. Sa i përket sigurisë dhe shëndetit në punë, IKSHPK ka dërguar katër persona për tu trajnuar në këtë lëmi, me qëllim të fitimit të statusit të ekspertit për siguri dhe shëndet në punë, si dhe për të zhvilluar aktivitetet e sigurisë dhe shëndetit në punë të parapara me legjislacionin në fuqi

Sfidat kryesore që kanë ndjekur IKSHPK-në gjatë vitit 2024 përfshijnë vështirësitë me drejtim strategjik, organizim të brendshëm, pamjaftueshmërinë buxhetore, kuadrin e pakët, probleme me pajisje të punës, probleme të natyrës profesionale dhe ngarkesa administrative.

Planet për vitin 2025 janë zbatimi i Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, për çka nevojiten edhe 40 pozita të reja dhe inicimi i funksionalizimit të QRSHP Prishtinë. Do të vazhdohet me aktivitetet e rregullta të IKSHPK si dhe me aktivitetet e parapara në planin e punës 2025 të cilat bazohen në Strategji Sektoriale Shëndetësore 2025-2030 dhe plane të ndryshme të veprimit. Aktivitete të reja të cilat presim ti realizojmë kanë të bëjnë me siguri dhe shëndet në punë gjegjësisht, të bëhen kontrolla sistematike të të punësuarve si dhe vlerësimi i sigurisë dhe shëndetit në punë.

2. Progresi me planin e punës – rezultatet kyçe

2.1 Departamenti i Epidemiologjisë

Departamenti i Epidemiologjisë ka bërë monitorim të vazhdueshëm të situatës epidemiologjike, përcjelljen e epidemive dhe ngjarjeve jo të zakonshme. Departamenti ka kryer hulumtimin e rasteve, grumbullimin, analizën dhe raportimin e të dhënave epidemiologjike me rekomandime përkatëse, si dhe ka bashkëpunuar ngushtë me institucione vendore dhe ndërkombëtare të shëndetit publik.

2.1.1 Sëmundjet ngjitëse

- Deri më 31.12.2024 janë raportuar 277,616 raste të sëmundjeve ngjitëse me incidencë 15,577.9/100,000 banorë, që është numër më i lartë në krahasim me vitin 2023
- Më së shumti raste të raportuara janë Sëmundja e ngjashme me gripin (ILI) me 138,825 raste ose incidencë 7,789.9/100,000 banorë përcjellë nga Diarea acute 108,077 raste me incidencë 6,064.5/100,000 banorë, ku të dyjat kanë pësuar rritje në krahasim me vitin 2023 (129,315 raste respektivisht 82,884 raste)
- Janë raportuar 1,732 raste me COVID-19 që është numër më i ultë se në vitin 2023 (2,153 raste)
- Rastet e raportuara të importuara janë: 4 malarie, 1 Lija M (Mpox) dhe 1 morbill
- Janë mbajtur 26 telekonferenca EpiTel me 6 QRSHP dhe 2 komuna të cilat kanë epidemiolog, për të koordinuar, ndarë informata dhe raportuar rregullisht lidhur me ngjarjet e rëndësishme epidemiologjike (si helmimet, chinokoku, West Nile virusi, Legionella, Lija M, sindroma meningjeale, morbilli etj)
- Raportimi i rasteve të West Nile Virus në Tessy, Raportimi në IHR dhe ELDSNet i rastit human me infeksion të Legionellës, dhe i rastit të Lijës M sipas IHR në OBSH, lidhur me udhëtime jashtë vendit
- Nga viti 2024, IKSHPK është pjesë e EpiTelit Regjional, me shtete të rajonit, 3 takime
- Në baza të rregullta periodike janë realizuar dhe publikuar në ueb faqen e IKSHPK-së, që nga funksionalizimi i ueb faqes së re:
 - o Buletinët javor Gripi sezonal 2024-2025, sipas javës
 - o Buletinët mujor të sëmundjeve ngjitëse, dhe
 - o Analiza e situatës epidemiologjike lidhur me COVID-19.
- Përcjellja e shfrytëzimit të sistemit digjital të menaxhimit të sëmundjeve ngjitëse SMSN dhe komunikimi me institucione shëndetësore për regjistrim të rasteve në këtë sistem
- Bashkëpunimi me inspektoratin sanitar në përgjigjen epidemiologjike
- Hartimi i Udhëzuesit/Protokollit për mbikëqyrje dhe kontrollë të rasteve (Lija M), version 2.0 dhe rekomandimet për udhëtarët nga Kosova në vendet e Afrikës
- Dorëzimi në MSh i Projekt Udhëzimit Administrativ “Ruajtja dhe mbrojtja e të dhënave personale për rastet e dyshimta, të mundshme dhe të konfirmuara nga sëmundjet ngjitëse”
- Është mbajtur ushtrimi simulues SimEX-multisektorial “Plani i parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes për pandemitë me patogjenë respirator”

Tabela 1. Numri i rasteve dhe incidenca e sëmundjeve ngjitëse, viti 2023-2024

Sëmundjet/shkaktarët	Janar-Dhjetor, 2023		Janar-Dhjetor, 2024	
	Nr.	Incidenca/ 100,000	Nr.	Incidenca/ 100,000
COVID-19	2,153	120.81	1,732	97.19
ITPR - Pneumonia/ARI	16,950	951.12	17,646	990.17
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	262	14.70	414	23.23
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	129,315	7,256.27	138,825	7,789.90
Influenca A	235	13.19	298	16.72
Influenca AH1N1	47	2.64		
Influenca A H3	1	0.06		
Influenca B	179	10.04	53	2.97
Influenca B/Victoria	29	1.63		
RSV	68	3.82	173	9.71
Human Adenovirus	4	0.22		
Diarea acute	82,884	4,650.88	108,077	6,064.54
Variçela	10,999	617.19	6,506	365.07
Sindromi meningjeal	232	13.02	153	8.59
EHSV	2	0.11	2	0.11
EHKK			1	0.06
Campilobacter	1	0.06		
Helmimet me ushqim	936	52.52	1,102	61.84
Rota virus	73	4.10	93	5.22
Salmonella enteritidis	76	4.26	46	2.58
Shigelloza	2	0.11		
Adenovirus			21	1.18
Enterovirus			16	0.90
Norovirus			3	0.17
Gastroenterokolitet	398	22.33	764	42.87
Hepatiti akut A	3		2	0.11
Hepatiti akut B	37	2.08	41	2.30
Hepatiti akut C	4	0.22	3	0.17
E.coli patogjene	2	0.11	4	0.22
Parotiti epidemik	30	1.68	32	1.80
Morbilli*	1	0.06	1	0.06
Pertussis	2	0.11	184	10.32
Tularemia	4	0.22	10	0.56
Brucellosis	33	1.85	50	2.81
Leishmaniazë	7	0.39	1	0.06
Leptospirosis	5	0.28	3	0.17
Toxoplazmozis	8	0.45	6	0.34
WNV	1	0.06	7	0.39
Malarie*	3	0.17	4	0.22
Sëmundja Lyme	12	0.67	8	0.45
TB	585	32.83	466	26.15
HIV/AIDS	20	1.12	34	1.91
IST	480	26.93	400	22.45
Echinococcus	2	0.11	5	0.28
Mpox*			1	0.06
Parazitoza	20	1.12		
Askariaza	7	0.39		
Giardiaza	46	2.58	30	1.68
Entameba Hystolitica	1	0.06	2	
Clostridium difficile	2	0.11		
Infeksionet streptokoksike të grupit A			119	6.68
Sëmundjet tjera ngjitëse (herpes zoster, mykozat, mononukleoza)	178	9.99	278	15.60
Gjithsej	246,339	13,822.85	277,616	15,577.89

*Raste të importuara

- Është mbajtur punëtorja “Komunikimi i rrezikut, angazhimi i komunitetit dhe menaxhimi i infodemisë”
- Sigurimi i gatishmërisë/kujdestarisë 24/7 sipas Ligjit për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr 08/L-200
- Stafi ka qenë pjesë e grupeve punuese për hartimin e Planit të veprimit për siguri shëndetësore, Planit të monitorimit të Projektligjit për Parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse dhe çështjeve të veçanta shëndetësore, si dhe e Planit të monitorimit për parandalimin, gatishmërinë, reagimin dhe rimëkëmbjen për pandemitë me patogjenë respiratorë.

2.1.2 HIV/AIDS/IST

Është kryer mbikëqyrja e rasteve të raportuara me HIV/AIDS/IST përmes grumbullimit, analizës dhe raportimit ditor, mujor dhe vjetor të rasteve në MSh, si dhe në TESSy dhe MCDDA, që ka mundësuar shkëmbimin e informacionit me partnerët ndërkombëtarë dhe ka kontribuar në përmirësimin e përgjigjes ndaj këtyre sëmundjeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ka vazhduar bashkëpunimi me ECDC, OBSH dhe institucione tjera në këmbim të informatave dhe përvojave për sëmundjet/infeksionet në fjalë.

- Gjatë vitit 2024 janë raportuar 34 raste të reja me HIV, që paraqet rritje në krahasim me vitin 2023 (20 raste).
- Pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e “Planit për aplikimin e fondeve në Fondin Global për HIV dhe TB 2025-2027”.
- Pjesëmarrja në Grupin Punues për hartimin e dokumentit strategjik dhe planit të veprimit për TB, HIV dhe IST 2025-2027.
- Realizimi i hulumtimit “Mapingu programor dhe vlerësimi i madhësisë së popullatave kyçe në Kosovë, 2024”
- Realizimi i hulumtimit “Mbikëqyrja e integruar biologjike dhe e sjelljeve tek popullata kyçe në Kosovë, 2024”.

2.1.3 Vaksinimi

Sa i përket vaksinimit, është përditësuar dhe shpërndarë Kalendar i rregullt i vaksinimit duke implementuar edhe tre vaksinat vaksina te reja (Rota, Pneumo dhe HPV), ndërsa ka vazhduar vaksinimi sipas indikacioneve epidemiologjike dhe të trafikut ndërkombëtarë, si dhe përkujdesja për Zingjirin e ftohtë:

- Mbulueshmëria me vaksinim sipas Kalendarit të rregullt për vitin 2024, në nivel vendi është 87% (duke llogaritur DTaP1 – 95%, DTaP3 – 78 % dhe MMR1 - 88 %). Ndryshimet në kalendarin e rregullt të vaksinimit me përfshirjen e tri vaksinave te reja përgjatë viteve 2023- 2024 kanë rezultuar me përqindje më të ulët të mbulueshmërisë duke qenë se DTaP 3 është spostuar nga muaj i katërt në muajin e gjashtë.
- Janë siguruar të gjitha vaksinat sipas kalendarit të rregullt, vaksinat me indikacion dhe sipas trafikut ndërkombëtar.
- Janë vaksinuar rreth 10,000 vajza të moshës 12 vjeç kundër HPV.
- Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2024/2025 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale. Nga 30 shtatori deri me 31 dhjetor janë administruar 64,011 doza; 42,884 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 19,687 me sëmundje kronike, 1,446 profesionistë shëndetësor, 3 gra shtatëzëna dhe 31 fëmijë (0-5 vjeç).

- Janë mbajtur 7 takime informuese për vaksinimin kundër gripit sezonal me mjekë familjar dhe klinikistë në të gjitha rajonet
- Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për përmirësimin e programit të vaksinimit dhe mbrojtjes kundër sëmundjeve ngjitëse, MSh dhe IKShPK kanë përditësuar Udhëzimin Administrativ 5/2010 me vaksinoprofilaksën, seroprofilaksën dhe kimioprofilaksën. Aktualisht, drafti i këtij udhëzimi është në fazën e konsultimeve paraprake.
- Shënimi i javës botërore të imunizimit - është mbajtur tryeza e rrumbullakët, emisione televizive dhe podcast, takime me prindër në shkolla dhe në komunitet vulnerabile.
- KPKI ka dhënë rekomandime për përfshirjen e djemve në vaksinimin HPV, për sigurimin e dozave për vaksinën kundër Mpox dhe për vaksinimin vullnetar të vajzave deri në moshën 21 vjeç.
- Mbi 550 mjekë dhe 1,664 infermierë janë trajnuar për ofrim të shërbimeve të vaksinimit.
- Vaksinimin plotësues dhe fushata "derë më derë" për identifikimin dhe vaksinimin e fëmijëve të pavaksinuar, veçanërisht në komunitetet vulnerabël si ato Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
- Janë mbajtur 350 sesione informuese për prindërit dhe mësuesit në shkolla për vaksinimin kundër HPV, duke mbuluar 4,311 prindër.
- Vendosja e linjave telefonike – shpërndarja e telefonave dhe mbushjeve për 12 muaj për të gjitha QKMF-të/Njësitë e vaksinimit.
- Hulumtimi kualitativ lidhur me aplikimin për herë të parë të HPV vaksinës.

2.1.4 Kontrolla sanitare dhe infeksione brendaspitalore

Ka vazhduar mbikëqyrja sanitare e të punësuarve dhe personave tjerë mikrobartës për ato kategori punonjësish të cilët mund të kontibudojnë në shfaqjen dhe përhapjen e sëmundjeve të caktuara ngjitëse tek popullata e cila është përdorues i produkteve/shërbimeve të tyre.

- Nga gjithsejt 42,387 vizita sanitare të kryera në nivel vendi gjatë këtij viti, 73.8% (apo 31,287 vizita) janë kryer në zyret e pranimit, ndërsa 26.2% (apo 11,100 sosh) janë kryer në terren. Nga të gjitha vizitat, 1,696 ose 4.0% e rasteve kanë rezultuar pozitive. Më së shumti raste pozitive janë regjistruar në QRSHP Prizren, 478 nga 6,644 vizita (7.19%). Nga bakteriet patogjene *Staphylococcus aureus* është izoluar më së shpeshti dhe atë në 1,382 raste (81.4%), ndërsa nga parazitët prinë *Giardia lamblia* e izoluar në 236 raste (13.9%).
- Hartimi i formës së re të raportimit për vizitat sanitare të realizuara sipas veprimtarive
- Hartimi dhe aplikimi i zbatimit të PSO Mbikëqyrja sanitare e personave të punësuar dhe personave tjerë mikrobartës, nga shkurt 2024
- Pjesëmarrja aktive në takimet e Këshillit për Infeksione Spitalore të QKUK. Dhënia e rekomandimeve bazuar në anketën brenda QKUK-së për njohuritë e stafit shëndetësor për infeksionet spitalore.
- Raportimi periodik mbi ecurinë e izolateve në QKUK dhe aktivitetet e ndërmarra
- Përmbyllja e kontratës për furnizim me libreza sanitare (Shërbime të printimit të librezave sanitare).
- Angazhimi në punën preventive në terren në kuadër të Departamentit të Epidemiologjisë.

2.1.5 Aktivitete tjera

Ngritja e kapaciteteve për reagim emergjent (hartimi i PSO-ve përkatëse)

- PSO-Aktivizimi dhe deaktivizimi i QOESHP
- PSO-Rekrutimi i personelit shtesë për QOESHP
- PSO-Menaxhimi i informacionit
- PSO-Raportimi ditor i situatës së shpërthimit të sëmundjes
- PSO-Raportimi javor i situatës së shpërthimit të sëmundjes.

Kryesimi i grupeve punuese të krijuara nga MSh, dhe finalizimi i dokumenteve:

- Grupi punues për hartimin e Planit të Gatishmërisë dhe reagimit ndaj pandemive të shkaktuara nga patogjenë respiratorë (PRET)
- Grupi punues për hartimin e Planit të vaksinimit
- Grupin punues për hartimin e Planit të Avokimit, Komunikimit dhe Mobilizimit social për tre vaksinat e reja
- Grupi punues për hartimin e Udhëzimit Administrativ për Vërejtjet e kombinuara, i hyrë në fuqi nga 1 shtatori 2024.

Udhëheqja me tri komitete, të cilat që nga themelimi (qershor 2024) kanë mbajtur 11 takime ku janë trajtuar tema me interes si Lija M (Mpox), Virusi i Nilit Perëndimor, Tri vaksinat e reja, Vaksina e Mpox dhe përfshirja e djemëve në vaksinën HPV.:

- Komitetin për Inteligjencë Epidemike (5 takime),
- Komiteti për Sëmundje Ngjitëse (3 takime) dhe
- Komiteti profesional për këshillim për imunizim (KPKI, 3 takime)

Pjesëmarrja aktive në katër (4) ushtrime simulative SimEX lidhur me emergjencat në shëndetin publik:

- Public Health Emergency Operations Centers (PHEOCs), 30 qershor-3 korrik, 2024, Stamboll
- SimEx multisektorial (në tavolinë), 29-30 shtator, 2024, Prishtinë
- Simex global: Ushtrimi global i simulimit (online), 13 nëntor, lidhje me OBSH-Adis Abeba -Etiopi,
- Start-Ex Jade 24, 14 nëntor 2024 (online), me zyrën e OBSH-së për Evropë
- Ushtrimi Tabletop për Komunikim dhe Koordinim në rast të paraqitjes së Influcencës Aviane (IKShPK, 02.08.2024)

2.1.6 Pjesëmarrja në grupe punuese, punëtori, trajnime, konferenca, vizita studimore për ngritje të kapaciteteve profesionale:

- Pjesëmarrja në workshopin e EURGen-ReflabCap të ECDC (22 janar, 2024)
- Pjesëmarrja në workshopin FWD AMR-RefLabCap (24-28 qershor, 2024)
- Pjesëmarrja në takimin e EURGen-Net (25-26 shtator, 2024)
- Pjesëmarrja në Grupin punues për hartimin e Procedurave Standarde Operative (PSO) për Rekrutimin e Personelit Shtesë në Qendrën Operative Emergjente të Shëndetit Publik.
- Pjesëmarrja në grup punues për rishikimin e Funksionit Mbështetës Emergjent (FME#8)
- Pjesëmarrja në grupin punues – Plani për Kontrollat Zyrtare 2025 (Inspektorati Sanitar)

Pjesëmarrja në workshopin për rezistencën antimikrobike me BE, ECDC dhe EFSA, 22-23 Maj, 2024, Prishtinë

- Në PLOS One publikohet punimi “Vlerësimi i efektivitetit të vaksinës COVID-19 kundër rasteve simptomatike dhe rasteve të rënda (vala e 4-të, korrik - shtator 2021) në Kosovë: analiza e të dhënave rutinë të mbikëqyrjes duke përdorur metodën e skriningut” Në web faqen e ECDC publikohet “Raporti përmbledhës i aktiviteteve të punës në MediPIET”
- Publikimi i hulumtimit të ECDC mbi prevalencën e infeksioneve të lidhura me kujdesin shëndetësor dhe përdorimi i antimikrobikëve në spitalet evropiane të kujdesit akut 2022-2023 (në hulumtim u përfshinë edhe të dhënat e prevalencës së një huumtimi të pis fokale për infeksioet lidhur me kujdesin shëndetësor - PPS HAI, të realizuar nga IKSHPK/OBSH/ECDC në Kosovë)
- Pjesëmarrja në takimin vjetor të ELDSNet, Dresden Gjermani 22-23 tetor të organizuar nga ECDC me qëllim të shkëmbimit të njohurive mbi temat aktuale lidhur me sëmundjen e Legionellozës.
- Pjesëmarrja në takimin vjetor të ECDC për sëmundjet emergjente që barten përmes vektorëve (Annual EVD Network Meeting, 12-13 nëntor 2024, Stockholm dhe hybrid).
- Pjesëmarrja në ECAIDE (European Scientific Conference on Applied Infectious Disease Epidemiology) dhe MediPIET Alumni Network (MediAN), 20-22 nëntor, Stockholm.
- Pjesëmarrja në takimin e dytë të Balkan Association for Vector-Borne Diseases (BAVBD) 28-29 nëntor, Pecs, Hungari. Në këtë konferencë u prezentua gjendja aktuale epidemiologjike në Kosovë e sëmundjeve që barten përmes vektorëve.
- Vizitë studimore në OBSH /EURO, UN, CITY, Nordhavn si dhe në Kopenhagë me qasje “Një shëndet “ si dhe SSI (Statens Serum Institut)/One health Institute
- Vizita të Pikës fokale dhe Ekuivalente të IHR- Poloni, përfaqësuesit nga Instituti i Shëndetit Publik-Varshavë dhe OBSH zyra regjionale Evropë
- Është mbajtur trajnimi multisektorial me 10 module për Risk Komunikim, Angazhim të komunitetit dhe menaxhim të Infodemisë (10-12 dhjetor në Prishtinë) në bashkëpunim me OBSH-në, në të cilën janë përfshirë mbi 30 pjesëtarë nga institucionet, shoqëria civile, komuniteti dhe influencues. Duke marrë parasysh edhe trajnimin në fillim të vitit, numri i të trajnuarave ka arritur në 50.
- Takimi i katërt rajonal me theks të veçantë vaksinimi kundër gripit dhe rritjes së kapaciteteve të KPKI, Durrës 2024
- Pjesëmarrja në takimin zyrtar të Pikave Fokale Kombëtare për IHR të organizuar nga OBSH dhe ECDC, të mbajtur në Sofje, Bullgari (23-26.09.2024).

2.2. Departamenti i Ekologjisë Humane

Departamenti i Ekologjisë Humane gjatë vitit 2024 ka realizuar detyrat e parapara me planin vjetor të punës, duke bërë Monitorimin e cilësisë dhe sigurisë të ujit për konsum human; Vlerësimin e kushteve higjieniko-sanitare në Instituconet Edukative, Arsimore, Aftësuese të arsimit Parauniversitar (IEAAP), shëndetësore dhe hoteliere; dhe Aktivitete tjera që ndërliken me fushëveprimin e departamentit.

2.2.1 Qendra e ujit

Monitorimi i cilësisë së ujit për pije në Kosovë kryhet sipas Udhëzimit Administrativ (UA) 10/2021 “ Për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor”. Neni 3 paragrafi 2.6 i UA 10/2021 ka përkufizuar se autoriteti shëndetësor në kuptim të këtij legjislacioni i referohet Qendrës së Ujit në kuadër të IKSHPK. Vlerësimi i cilësisë së ujit për pije realizohet sipas Planit të Monitorimit të përputhshmërisë (neni 9) i cili bazohet në ndarje të zonave të furnizimit (47 zona të menaxhuara nga 7 kompani rajonale të ujësjellësit) dhe ekzaminimet laboratorike të ndarë sipas rutinave:

R1- turbullira, klori rezidual dhe parametrat bakteriologjik

R2- parametrat e analizës bazike kimike

R3- Metalet e rënda, pesticidet, karboni total organik dhe trihalometani

Gjatë vitit 2024 janë analizuar 11,631 mostra të ujit prej të cilave 97.66% janë në përputhshmëri me vlerat parametrike të UA Nr. 10/2021, (tab.2).

Tabela 2. Rezultatet e analizave të ujit sipas rajoneve

Rajoni	R1		R2		R3		Gjithsej		
	*N	*NJS	*N	*NJS	*N	*NJS	*N	*NJS	*% JS
Prishtina	1,536	21	768	27	46	0	2,350	48	2.04
Gjilani	810	2	550	13	35	0	1,392	15	1.08
Gjakovë	673	0	407	0	30	0	1,110	0	0.00
Prizren	1,644	4	660	6	70	0	2,374	10	0.42
Pejë	1,459	123	682	20	8	0	2,149	143	6.65
Mitrovicë	900	5	300	3	16	1	1,200	9	0.75
Ferizaj	480	15	543	26	33	8	1,056	47	4.45
Gjithsej	7,502	170	3,910	95	238	9	11,631	272	2.34

*N-numri i mostrave, *NJS- numri i mostrave jashtë standardi, *% Jashtë standardi

Numri i mostrave të ujit të cilat janë analizuar në QRSHP Ferizaj nga pusët private është 169, prej tyre 60 ose 35.5 % janë jashtë standardeve për ujin e pijes.

2.2.2 Cilësia e ujit për pije gjatë rritjes së vlerave të Manganit në burimin e ujit “Badoc”

Gjatë vitit 2024 është ri paraqitur “fenomeni” i Manganit në Liqenin e Badocit si dukuri e vazhdueshme e cila ndodh kryesisht në kohën e ndërrimit të stinëve. Kjo dukuri këtë vit ishte edhe më shqetësuese sepse përveç vlerave të shtuara të Mn 2+ edhe kohëzgjatja ishte më e madhe (44 ditë, pjesa e dytë e shtatorit deri në pjesën e parë të nëntorit).

Gjatë kësaj kohe janë marrë 455 mostra për analizë të Manganit në ujin e pijshëm të trajtuar në Impiantin e Trajtimit të Ujit për pije në Badoc prej nga furnizohen banorët e Zonës së Furnizimit PR03 (Prishtinë, Hajvali, Çagllavicë dhe Graçanicë) dhe 79.56% kanë rezultuar me vlera të rritura të Manganit, (tab.3).

Tabela 3. Rezultatet e analizave të Manganit në ujin e pijshëm

Rajoni	Shtator		Tetor		Nëntor		Gjithsej		
	*N	*NJS	*N	*NJS	*N	*NJS	*N	*NJS	*% JS
PR03	16	1	319	278	120	83	455	362	79.56

*N-numri i mostrave,*NJS- numri i mostrave jashtë standardi, *% Jashtë standardi

Sipas UA Nr. 10/2021 "Për cilësinë e ujit të destinuar për konsum nga njeriu", norma e lejuar për Mangan në ujin për pije është 0.05 mg/L.

2.2.3 Cilësia e ujit për pije pas ngjarjes në kanalin e Ibër Lepencit

Pas ngjarjes në kanalin Ibër-Lepenc, datë 29 nëntor 2024, ekipet e IKSHPK dhe QRSHP janë mobilizuar dhe kanë percjellë situatën e furnizimit nga rrjeti shpërndarës i KRU "Mitrovica" dhe KRU "Prishtina" të cilët furnizohen me ujë nga ky kanal.

IKSHPK dhe QRSHP-Mitrovicë gjatë këtyre ditëve nga të gjitha impiantet e lartëcekura kanë marrë gjithsej 100 mostra të ujit për analiza fiziko-kimike, 100 për analiza bakteriologjike si dhe 13 mostra për analiza në metale të rënda (në ujin e pa trajtuar dhe ujin nga rrjeti shpërndarës).

2.2.4 Mbikëqyrja e kushteve higjieniko - sanitare

Gjatë vitit 2024 është bërë vlerësimi i kushteve higjieniko-sanitare në Institucione Edukative, Arsimore, Aftësuese të arsimit Parauniversitar (IEAAP), spitale të përgjithshme, restorane, lagje të ndryshme:

- Është bërë vlerësimi në 51 shkolla dhe 14 çerdhe (publike dhe private). Vetëm 59.46% e shkollave dhe 64.29% e çerdheve kanë rezultuar me vlerësim të kënaqshëm
- Në çerdhet në Gjilan dhe Ferizaj, prej 374 strishove të marra nga sipërfaqet punuese, uniformat dhe duart e personelit të cilët punojnë në kuzhinat e çerdheve, 21 apo 5.61% e tyre kanë rezultuar me kontaminim bakteror
- Është bërë vlerësimi i kushteve higjieniko-sanitare në 3 spitale të përgjithshme: Gjilan, Prizren dhe Ferizaj, me ç'rast janë marrë 292 strisho nga sipërfaqet punuese, uniformat dhe duart e personelit dhe 9 apo 3.08% të tyre kanë rezultuar me kontaminim bakteror
- Në rajonin e Ferizajit dhe Prizrenit, me kërkesë të inspektorëve sanitarë, në disa restorane janë marrë 63 strisho nga sipërfaqet punuese, uniformat dhe duart e personelit nga të cilat 20 apo 31.75% kanë rezultuar me kontaminim bakteror
- Me kërkesën e banorëve të lagjes Qëndresa, për shkak të kundërmimit nga kanali Ibër-Lepenc, është bërë inspektimi i kësaj lagjeje dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse për banorët e lagjes dhe strukturat relevante
- Në lagjen Kalabria, me kërkesën e Avokatit të Popullit, për kundërmimin nga përrocka që kalon në lagje, është bërë inspektimi i kësaj lagjeje dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse për banorët e lagjes dhe strukturat relevante.

2.2.5 Aktivitete tjera

- Menaxhimi i situatës gjatë rritjes së vlerave të Manganit në burimin e ujit "Badoc"
- Menaxhimi i situatës pas ngjarjes në kanalin e Ibër-Lepencit
- Menaxhimi i situatës gjatë vërshimeve në rajonin e Gjakovës
- Menaxhimi i dy epidemive (helmim me ushqim) në rajonin e Ferizajit. Në të dy rastet gjithsej janë përfshirë 25 persona me simptomatologji të helmimit me ushqim.

2.2.6 Pjesëmarrje në trajnime dhe punëtori

- Takime të rregullta profesionale të Komisionit për ujin e pijshëm
- Takim pune me KRU "Prishtina" për çështjen e vlerave të rritura të Manganit në liqenin e Badocit

- Përgatitja e planit ditor për marrjen e mostrave për monitorimin e ngritjes së nivelit të përqëndrimit të Mn në ujin për pije që merret nga liqeni akumulues në Badoc
- Inspektimi, mostrimi dhe analiza e rezultateve të ujit nga aparati për hemodializë në Rahovec
- Takime të rregullta profesionale në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vlerësim dhe autorizim të produkteve për mbrojtjen e bimëve
- Takim pune për përgatitjen e Draft Udhëzimit për Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim
- Takim pune për iniciimin e kërkesës së Autoritetit Rregullator për shërbime të Ujit-ARRU për avancimin e sistemit informativ për monitorimin e standardeve të shërbimeve të KRU-ve, për monitorimin operacional të cilësisë së ujit për pije dhe përshtatshmëria me sistemin e mbikqyrjes së cilësisë së ujit, në IKSHPK
- Pjesëmarrje në prezantimin e raportit të UNICEF-it: analizë mbi gjendjen klimatike për fëmijët (CLAC)
- Pjesëmarrje në takimin "Klima në fokus: Dokumentimi i një bote në ndryshim - duke shënuar pjesëmarrjen e Kosovës në COP29", "Think Green, Act Green" i financuar nga Gjermania
- Pjesëmarrje në takimin e grupit punues "Monitorimi dhe zbatimi i planit strategjik dhe planit të veprimit për menaxhimin e mbeturinave medicinale 2024-2026"
- Pjesëmarrje në grupin punues për hartimin e PSO "Mbikëqyrja sanitare e personave të punësuar dhe personave tjerë mikrobartës"
- Takim pune i grupit punues "Emergjencat nga rrezatimi - Mekanizmat e krijuar dhe funksional për zbulim dhe reagim ndaj emergjencave radiologjike dhe bërthamore"
- Pjesëmarrje aktive në 12th European Conference on Health Promotion, Poloni
- Pjesëmarrje në 7th International Conference on Salutogenesis
- Takime të Kolegjiut Mbikëqyrës dhe Hulumtues Shkencor të Shëndetësisë Publike
- Pjesëmarrje në ushtrimin Tabletop për komunikim dhe koordinim në rast të paraqitjes së rasteve me Influcencë Aviane
- Pjesëmarrje në takimin Affordable access to health care: monitoring financial protection and out-of-pocket payments in the EU and the Western Balkans
- Pjesëmarrje në punëtori: "Orientimi themelor për zhvillimin e Planit Strategjik të Shoqatës së ujësjellësve dhe kanalizimit të Kosovës-SHUKOS 2026 – 2031;

2.3. Departamenti i Mikrobiologjisë

Departamenti i Mikrobiologjisë, IKSHPK Prishtina gjatë vitit 2024 ka vazhduar me kryerjen e detyrave dhe përgjegjësitë të përcaktuara në legjislacionin e Kosovës. Të njëjtat janë paraqitur në vijim.

2.3.1 Shërbimet mikrobiologjike

Në Departamentin e Mikrobiologjisë gjatë vitit 2024 janë kryer gjithsej 288,231 ekzaminime mikrobiologjike. Numri më i lartë i shërbimeve është ofruar në IKSHPK me gjithsej 169,607 shërbime, prej tyre më së shumti (37,556) kanë qenë testet serologjike me ELISA për detektimin të antitropave/antigjeneve ndaj/të patogjenëve të ndryshëm infektiv. Në gjithë

sektor shëndetësor të Kosovës, Departamenti i Mikrobiologjisë, IKSHPK Prishtinë është i vetmi institucion që kryen këtë shërbim diagnostik për sëmundje infektive. Me metoda tjera serologjike të aglutinimit, janë kryer edhe 1,700 testime (aglutinim, imunofluorescencë).

Nga QRSHP janë ofruar gjithsej 118.624 shërbime, me numër më të madh të mostrave urogenitale dhe respiratore, pasuar nga mostra të infeksioneve të traktit digjektiv dhe diagnostikimeve për parazitë. Numri i mostrave për diagnostikë molekulare në regjione është dukshëm më i ulët për shkak të uljes së rasteve me Sars Cov-2.169,604 ekzaminime mikrobiologjike (tab.4).

Tabela 4. Mostra të pranuar sipas laboratoreve të mikrobiologjisë dhe rajoneve, 2024

Nr	Diagnostikimet laboratorike	Prishtinë	Pejë	Prizren	Gjilan	Mitrovicë	Ferizaj	Gjakovë	Gjithsej
1	Mostra urogenitale	16,323	4,266	1,703	4,668	11,537	4,157	2,311	44,965
2	Mostra respiratore	13,700	5,003	3,154	7,125	4,868	978	5,509	40,337
3	Ekzaminime në parazite	21,297	1,303	8,234	3,039	2,701	1,666	3,313	41,553
4	Mostra për infeksione të traktit digjektiv	4,845	1,238	5,800	3,388	967	86	1,801	18,125
5	Tuberkulozë	8,361		1,095		1,275		135	10,866
6	RT PCR	8,956	104	103			60	862	10,085
7	Ekzaminime serologjike me aglutinim	1,700	553	834	46	430	63	106	3,732
8	Mostra për infeksione intrahospitalore	4,426	344	672	405	761	1,038	173	7,819
9	ELISA	37,556							37,556
10	Ekzaminime sanitare	52,443	4,867	6,644	360	3,817	5,062		73,193
	Gjithsej	169,607	17,678	28,239	19,031	26,356	13,110	14,210	288,231

2.3.2 Ngritje e kapaciteve laboratorike

Gjatë vitit 2024 i është dhënë rëndësi forcimit të kapaciteve laboratorike, me theks në sekuencionimin gjenetik të patogjenëve të rëndësishëm për shëndetin publik të Kosovës. Në këtë aspekt, përpos përkrahjes nga MSH, është siguruar mbështetja nga organizata joqeveritare Community Development Fund, e financuar nga Global Fund to Fight AIDS, TB and Malaria – GFATM, pastaj nga Robert Koch Institute, Berlin, Gjermani si dhe Bernard Nocht Institute, Hamburg, Gjermani. Aktivitetet e kryera në këtë aspekt:

- Sigurim i materialit harxhues laboratorik për sekuencionim të HIV, TB-së, Influcencës, HBV, HCV, SARS-CoV-2
- Sigurim i pajisjeve laboratorike të nevojshme për përgatitjen e terreneve ushqyese në mënyrë automatike, autoklave, dejonizues, përfshirë edhe një aparat të ri për sekuencionim ISeq 100 Illumina
- Trajnime për sekuencionim të patogjenëve të rëndësishëm për shëndetin publik të Kosovës të zhvilluara në IKSHPK, në Bernard Nocht Institute, Hamburg, Gjermani, Robert Koch Institute, Berlin, Gjermani, Institutin e Mikrobiologjisë dhe Imunologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Ljubljana, Slloveni, Laboratori referent për Influcencë të Greqisë veriore, Selanik, Fakulteti i Mjekësisë i Aristotelit. Greqi, etj.

2.3.4 Zhvillimi i sistemit për menaxhimin e cilësisë në laborator

Laboratorët e D.Mikrobiologjisë kanë marrë pjesë në programe të kontrollës së jashtme për disa patogjen të rëndësishëm për shëndetin publik të Kosovës, SARS-CoV-2, Influenza, Fruth dhe Rubella si dhe bakterieve rezistente. Gjithashtu, me ndihmën e OBSH, Zyra Rajonale për Evropë, kemi pasur mbështetje nga një ekspert ndërkombëtar nga Holanda, National Institute

for Public Health and Environment, Bilthoven, Holandë, në zhvillimin e sistemit për menaxhimin e kualitetit në laborator me qëllim të përgatitjes së Departamentit për hyrje në proces të akreditimit. Në këtë kuadër, poashtu është punuar në unifikimin e dhjetë proceseve të ndryshme të punës laboratorike, prej të cilave pritet të hartohen dhe miratohen 10 PSO përkatëse. Po ashtu, janë mbajtur tri punëtori (qershor, tetor dhe dhjetor 2024) me ekspertin nga OBSH për standarde të cilësisë në laboratore, ngritjen e standardeve të cilësisë ë laboratore dhe menaxhimi i incidenteve me mostra patogjene.

2.3.5 Zhvillimi i udhërrëfyesve dhe politikave shëndetësore

Personeli i Departamentit të Mikrobiologjisë ka udhëhequr ose kanë qenë pjesëmarrës aktiv në zhvillimin e një numri të konsiderueshëm të udhërrëfyesve klinik, PSO, udhëzimeve administrative si dhe të strategjive kombëtare. Këtu vlen të përmenden:

- Hartimi dhe aprovimi i Planit strategjik kombëtarë të Kosovës për laboratorë 2024-2030
- Hartimi i udhërrëfyesit klinik për kulturën e gjakut dhe mostrave të tjera sterile të njeriut
- Hartimi i PSO për kujdestarinë e antimikrobikëve
- Përgaditja e planit të veprimit për rezistencën antimikrobike dhe kontrollën dhe parandalimin e infeksioneve të ndërlidhura me kujdesin shëndetësorë në bashkëpunim me European Center for Disease Control, ECDC
- Pjesëmarrja në hartimin e “Planit për parandalimin, gatishmërinë, reagimin dhe rimëkëmbjen për pandemitë me patogjenë respirator”
- Pjesëmarrja në hartimin e “Planit për siguri shëndetësore”
- Hartimi dhe dorëzimi i draftit të udhëzimit administrativ për Kriteret, procedurat, masat e biosigurisë dhe biosigurimit për transportin e mostrave për qëllime diagnostike të sëmundjeve ngjitëse
- Zhvillimi i detyrave të punës dhe kërkesës për nominimin e laboratorëve referente të Kosovës për Influcencën si dhe të laboratorit për Fruth dhe Rubellë në IKSHPK.

2.4 Departamenti i Mjekësisë Sociale

Departamenti i Mjekësisë Sociale ka kryer aktivitetet të cilat lidhen me shëndetin e nënës, fëmijës dhe të rinjëve, me promovimin dhe edukimin shëndetësor të popullatës si dhe aktivitete tjera të përbashkëta.

2.4.1 Observatori për shëndetin e nënës, fëmijës dhe të rinjëve

Aktivitetet kryesore në këtë njësi janë përqëndruar në vlerësimin e gjendjes shëndetësore të grupacioneve vulnerable. Aktivitetet kryesore të njësisë janë:

- Vlerësimi i gjendjes shëndetësore të grupacioneve vulnerable dhe përgatitja e raportit të gjendjes perinatale në Kosovë për vitin 2023.
- Pjesëmarrja në takime pune për hartimin e dokumenteve të ndryshme ligjore dhe strategjike.
- Organizimi i takimeve dhe puna e rregullt në Komisionin vlerësues për udhërrëfyesit dhe protokollet klinike.
- Shqyrtimi dhe përgatitja e materialeve edukativo shëndetësore si dhe miratimi i tyre.
- Takime e tryeza për Kancerin e Qafës së Mitrës, skringun dhe vaksinimin me HPV.

- Trajnime me nxënësit e shkollave të mesme profesionale për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues si dhe me OBSH modulën për vaksinim "Immune patrol".
- Trajnime me profesionistët shëndetësor me tema të ndryshme në kuadër të vizitave shtëpiake, në bashkëpunim me AMC/UNICEF dhe MSH/KPSH.

2.4.2 Promovimi dhe Edukimi Shëndetësor

- Koordinimi dhe Organizimi i shënimit të ditëve, javëve dhe fushatave të caktuara Ndërkombëtare që kanë të bëjnë me shëndetin si Java e kancerit të qafës së mitrës, Dita Botërore e tuberkulozit, Shëndetit, Duhanit, Hipertensionit, Muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Drogave, Zemrës, Diabetit, HIV/AIDS, personat me aftësi të kufizuara
- Hartimi, përgatitja/miratimi dhe distribuimi i materialeve të informimit, edukimit dhe komunikimit me tema të veçanta, si dhe shqyrtimi dhe miratimi i materialeve promovuese
- Bashkëpunimi me organizata qeveritare dhe jo qeveritare si dhe media për hartimin e dokumenteve dhe realizimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me programe edukativo shëndetësore (AQH, IHS, Policia, Institucionet shkollore, KKK, OBSH, UNICEF, UNFPA, KOPF, Save the Children, etj.)
- Mirëmbajtja dhe postimi i informatave të ndryshme në faqen e edukimit shëndetësor në rrjetin social Facebook
- Aktivitete tjera të promovimit dhe edukimit shëndetësor (tab. 5).

Tabela 5. Aktivitete të promovimit dhe edukimit shëndetësor, 2024

Nr.	Institucioni	Takime të KESH	Trajnime		Ligjërata		Shënimi i ditëve	Distribuimi i materialeve				Gjithsej		Temat										Gjithsej tema të realizuara
			Numri i trajnimeve	Numri i pjesëmarrësve	Numri i ligjëratave	Numri i pjesëmarrësve		Fletëpalosje	Poster	Broshurë	Tjetër	Numri i pjesëmarrësve (Fushata)	Numri i materialeve (Fushata)	Duhanpirja	Narkomania	Alkoholi	HIV/AIDS	Aktiviteti fizik	Dhuna	Aksidentet në komunikacion	Shëndeti seksual dhe riprodhues	Kqushqyeshmëria	Tjetër (shënimi):	
1	QRSH-Pj. Gjakovë	20			42	12,530	8	10,300	50	700	1,100	12,550	12,150	20			30					10		60
2	QRSH-Pj. Mitrovicë	12			159	4,753	8	8,300	22	520	318	4,753	9,160				16							16
3	QRSH-Pj. Prizren	47	12	552	95	16,450	8	11,000	64	1,156	1,594	17,002	13,814	8			30							38
4	QRSH-Pj. Gjiçan	12			140	10,190	8	7,860	40	710	580	10,190	9,190	10	2	3	8	12	10	10	2	3		60
5	QRSH-Pj. Pejë	12			162	9,040	8	8,830	20	600	230	9,040	9,680	38	8	15	8	27	2	25	2	8	20	153
6	QRSH-Pj. Ferizaj	12			133	9,215	8	7,580	23	460	10	9,215	8,073											
7	IKSHPK Prishtinë	10	64	1,175	190	5,200	11	34,290	350				34,640											17
8	Totali	125	76	1,727	921	67,378	11	88,160	569	4,146	3,832	62,750	96,707	76	10	18	92	39	12	35	4	21	37	344

2.4.3 Aktivitetet tjera

- Përpilimi i raportit për MSh lidhur me aktivitetet dhe planin e veprimit për komunitetet Rom, Ashiikalinj dhe Egjiptas në shoqërinë Kosovare
- Raportimi periodik i procesit të monitorimit të dokumenteve strategjike
- Raportimi për barazinë gjinore në politikat shëndetësore
- Vlerësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës dhe grupacioneve të saj në dokumentin e analizës së gjendjes shëndetësore në Kosovë

- Vazhdim pune në vlerësimin e metodologjisë së adaptimit të UPK
- Pjesëmarrja në takimet dhe punëtoritë e Komitetit ndërmnistror të Shkollave Promovuese të Shëndetit dhe hartimin e Raportit
- Pjesëmarrja në trajnimet për Intervistimin Motivues me Infermieret e KPSH të organizuar nga AQH
- Pjesëmarrja në punëtoritë për komunikimin e riskut dhe angazhimin e komunitetit për vlerësimin e sjelljeve të popullatës
- Pjesëmarrja dhe prezantimi i punimeve në Konferencën ndërkombëtare të IUHPE në Lodz të Polonisë
- Pjesëmarrja në trajnimet për shëndetin seksual dhe riprodhues me nxënësit e shkollave profesionale dhe arsimtarëve në bashkëpunim me UNFPA / KOPF
- Shqyrtimi i materialeve “Ndërhyrja edukative për përmirësimin e qëndrimeve, praktikave dhe sjelljes ndaj ndotjes së ajrit”
- Pjesëmarrja në takime vendore e ndërkombëtare të shëndetit seksual dhe riprodhues
- Pjesëmarrja në grupet punuese për hartimin e akteve ligjore dhe dokumenteve strategjike:
 - Pjesëmarrja në takimet e Bordit për parandalimin dhe kontrollin e kancerit
 - Pjesëmarrje në takimet e Këshillit të Statistikave të Kosovës
 - Pjesëmarrje në grupin punues për Statutin e IKSHPK
 - Shqyrtimi i dokumenteve strategjike për hartimin e planit vjetor të aktiviteteve të departamentit për vitin 2025
 - Krijimi i databazës për ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret relevante në fushën e shëndetësisë
 - Pjesëmarrja në punëtorinë për planin e veprimit për strategjinë e shëndetit të nënës dhe fëmijës
 - Pjesëmarrja në takimet e Komisionit të imunizimit dhe KPKI
 - Vazhdim pune me OBSH për raportin e mbrojtjes financiare
 - Pjesëmarrja në punëtoritë e Bankës Botërore për hartimin e koncept-dokumentit për projektin e ri.
 - Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit të Promovimit dhe Edukimit Shëndetësor, Spitaleve të shëndetshme, Burimeve njerëzore dhe Sëmundjeve jo ngjitëse
 - Pjesëmarrja në Punëtoritë për hartimin e Planit të Veprimit për trajtimin e fëmijëve abuzues me narkotikë
 - Pjesëmarrja në Punëtoritë për hartimin e Planit të Veprimit për parandalimin e martesave të hershme
 - Pjesëmarrja në grupin punues për Strategjinë e sëmundjeve ngjitëse dhe Planin e Veprimit për Sëmundje ngjitëse 2022–2024 dhe Ligjin e sëmundjeve ngjitëse.
- Puna në aktivitetet e identifikuara në Planin e Veprimit për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Strategjinë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në republikën e Kosovës 2022-2026 dhe plani i veprimit 2022-2024:
 - Plotësimi i pjesës së planifikimeve të Promovimit dhe Edukimit Shëndetësor në Planin e Veprimit për të Drejta e Personave me Aftësi të Kufizuara 2024 – 2026

2.4.4 Trajnimet dhe takimet

- Pjesëmarrja në trajnime, punëtori dhe konferenca vendore dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me fushat e shëndetësisë publike dhe promovimit dhe edukimit shëndetësorë si

European Health Management Association (EHMA), European Training Consortium-Public Health and Health Promotion (ETC-PHHP), International Union of Health Promotion and Education (IUHPE), Comprehensive Sexuality Education (CSE), Behavioral Cultural Insights (BCI), projekti Komisionit Evropian për skringun e kancerit (Eutopia,) Higher Education Research and Applied Science Plus – HERAS+, sisteme shëndetësore, klasifikimin ndërkombëtar të sëmundjeve, cilësinë, etj.

- Pjesëmarrje në simpoziume ndërkombëtare për promovim dhe edukim shëndetësor dhe webinar
- Pjesëmarrja në mbledhjet të rregullta të Bordit të IKShPK, Këshillit profesional të IKShPK, departamentit dhe Komisionit të edukimit shëndetësorë në nivel qendror, rajonal dhe komunal
- Pjesëmarrja në punëtorinë për komunikimin e Riskut me OBSH dhe UNICEF
- Pjesëmarrje në aktivitetet e informimit, edukimit, komunikimit dhe vetëdijësimit përfshirë vaksinimin, fushatat senzibilizuese për popullatën dhe institucionet
- Pjesëmarrja në Concha Colomer Symposium (hibrid) dhe takimin me rrjetin european të trajnerëve të ETC-HPPH në Alicante, Spanjë
- Takime pune në Këshillin e Statistikave të Kosovës
- Realizimi i hulumtimit me Personat me aftësi të kufizuara
- Pjesëmarrja në takimet e këshillit organizativ të IUHPE për organizimin e konferencës së IUHPE në vitin 2024 në Lodz të Polonisë
- Pjesëmarrja në takimet online të organizuar nga OBSH për projektin “Mbrojtja financiare e sistemit shëndetësor në Kosovë”
- Përgatitja e raportit të punës të Departamentit të Mjekësisë Sociale për periudhën Janar – Dhjetor 2024
- Pjesëmarrja në programin e trajnimit 2 vjeçar (fellowship) të ECDC, MediPIET 2022 / 2023
- Përgatitja dhe dorëzimi i raporteve nga hulumtimet e mëparme pranë OMK
- Analizimi i dokumenteve të Avokatit të Popullit për rolin e IKShPK, Sistemit informativ shëndetësor, Shëndetit seksual dhe riprodhues dhe përgatitja e shkresave me përgjigje
- Trajnime me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

2.5 Qendra e Laboratoreve Testuese

Qendra e Laboratoreve Testuese (QLT) gjatë vitit 2024 ka realizuar aktivitete në monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm (urban, rural, të ambalazhuar), ujit të pishinave, ushqimit, mjedisit të brendshëm, si dhe ka kryer aktivitete tjera për fuqizim të kapaciteteve profesionale.

2.5.1 Monitorimi i cilësisë së ujit

Janë analizuar 4,586 mostra të ujit në laboratorë të ndryshëm të QLT -së:

- 2,486 mostra janë analizuar për përshtatshmëri mikrobiologjike,
- 2,050 mostra janë analizuar për përshtatshmëri fiziko-kimike,
- Në laborator analitik organik janë kontrolluar 98 mostra të ujit,
- Në laborator analitik inorganik 369 mostra të ujit.

- Është mbajtur trajnimi praktik për matjen e parametrave tregues të kualitetit të ujit në terren (pH, turbullira, përçueshmëria elektrike dhe temperatura).

2.5.2 Monitorimi i cilësisë së ushqimit:

- Percjellja dhe monitorimi i prezencës së toksinave kimike dhe mikrobiologjike në ushqim është bërë me 859 mostra ushqimi të testuara në parametra mikrobiologjik dhe 819 mostra të testuara në laboratorin e bromatologjisë
- Percjellja dhe monitorimi i aditiveve, metaleve të rënda, mykotoxinave në ushqim, ku janë 13 mostra të testuara për prezencë të metaleve ndërsa 2 në mykotoksina
- Percjellja dhe monitorimi i trihalometanit, karbonit organik total, metaleve të rënda dhe mineraleve në ujërat e pijshëm dhe rekreativ
- Vizita tek të gjithë prodhuesit vendorë të cilët kanë kontratë me IKSHPK – në, ku janë marë 506 mostra të ushqimit, 1,060 mostra të ujit dhe 287 strisho në ambiente prodhimi apo nga duart e personave që punojnë me ushqim
- Është bërë testimi i të gjitha mostrave të ardhura nga AUV si dhe përmes kërkesave individuale.

2.5.3 Monitorimi i ambientit të brendshëm

Janë analizuar 88 parametra (dioksidi i azotit, formaldehidet, benzeni, monoksidi i karbonit, dioksidi i karbonit, temperatura, lagështia relative dhe materjet grimcore PM_{2.5}) në institucionet publike parashkollore në komunën e Prishtinës, përmes vendosjes së sensorëve brenda objektit dhe në oborrin e çerdheve, ku kanë qëndruar 5 ditë para se të analizohen në laboratore të QLT. Vlen të theksohet se për herë të parë është matur në mjediset e brendshme edhe PM_{2.5} parameter ky i analizuar me Purple air sensor.

2.5.4 Aktivitete tjera

- Pjesëmarrje e laboratoreve të QLT në verifikimin e kualitetit të analizave (Proficiency Testing – PT) për Plumb në gjak me CDC-Atlanta /USA
- Pjesëmarrje e laboratoreve të QLT - në verifikimin e kualitetit të analizave (Proficiency Testing – PT metalet e rënda) me Labororet e KUR “Prishtina”
- Pjesëmarrje në grupin punues Mbikëqyrja shëndetësore e personave të punësuar dhe personave tjerë bacil bartës
- Pjesëmarrje në grupin punues për hartimin e Planit të Veprimit për Siguri Shëndetësore 19 Mars 2024, bazuar në vendimin 205/III/2024 të datës 13/03/2024
- Punëtorja për rezistencën antimikrobike me Bashkimin Evropian, ECDC dhe Autoriteti evropian i sigurisë së ushqimit (EFSA) 22-23 maj 2024
- Sub-regional workshop on Joint Risk Assessment for Zoonotic Diseases in the Western Balkans 11-13 September 2024, Sarajevo, Bosnia & Herzegovina
- Trajnimi për Vidas KUBE nga Biotek Kosova 13 Shtator 2024
- Kongresi i 7 i Mikrobiologëve të Maqedonisë 20-22 Shtator 2024
- Mbledhja e IHR Sofje nga data 24-25 Shtator 2024
- Pjesëmarrje në grupin punues për monitorimin e zbatimit të planit strategjik kombëtar për laboratore 2024-2030
- Pjesëmarrja në hartimin e UA-Kriteret, procedurat, masat e biosigurisë dhe biosigurimit për transportin e mostrave për qëllime diagnostike të sëmundjeve ngjitëse organizuar nga MSH me datat 02-03.10.2024, Hotel International Prishtinë

- Hulumtimi i bërë gjatë vitit 2022-23 nga 16 ekiye të të gjitha QRSHP dhe QLT-së/IKSHPK, me Dr. Antigona Ukëhaxhaj si kordinatore e projektit "Healthier Kosovo 2" e financuar nga zyra e OBSH-së, UNDP dhe UNV u publikua me datë 08.11.2024 nga zyra e OBSH në Bon me gjetjet e raportit. Raporti është përkthyer edhe në gjuhën shqipe dhe është në pritje të publikimit
- Pjesëmarrja në Konferencën e tretë globale të Shëndetit Publik dhe Menaxhimit Shëndetësor, në Londër me punimin "Sources of Indoor Air Pollution in schools in Kosovo"
- Pjesëmarrja në mobilitet në Universitetin e Vjenës- Fakultetin e Mjekësisë dhe Institutin e Shëndetit Publik, ku qëllim kishte matjet në ajër dhe në veçanti partikulat, bashkëpunimet dhe trajnime, në kuadër të projektit të Universitetit të Prishtinës "NANOKOS"
- Pjesëmarrja në Konferencën Ndërkombëtare me punimin "Research of chronic diseases and indoor air quality in Kosovo households" 2024
- Pjesëmarrje në Konferencën Kombëtare të Shkencave Mjekësore, në Tiranë prezetim oral me titull: "Indoor air quality in Kosovo". 2024
- Pjesëmarrje në International Congress on Natural, Health Sciences and Technology, Tetovë prezetim oral me titull "Personal Exposure to chemical contaminants in households cooking with wood and coal in Kosovo" 2024.

2.6 Departamenti i Statistikave Shëndetësore

Departamenti i Statistikave Shëndetësore në IKSHPK për periudhën Janar-Dhjetor 2024 ka vazhduar me aktivitetet rreth grumbullimit dhe përpunimit të statistikave shëndetësore nga institucionet publike dhe disa institucione private në Kosovë, dhe si rezultat janë përfunduar 14 (katërmëdhjetë) Vjetarë statistikor për vitin 2023.

2.6.1 Vjetarët statistikor për vitin 2023

- Burimet njerëzore, aktivitetet dhe indikatorët në QKUK-Midnight statistika
- Raporti i morbiditetit në Kujdesin Tretësor Shëndetësor (QKUK) –Vjetari statistikor
- Resurset humane në shëndetësinë e Kosovës (sektori publik) gjendja 31.12.2023-QKUK-Vjetari statistikor
- Burimet njerëzore, aktivitetet dhe indikatorët në spitalet rajonale- Midnight statistika 2023
- Raporti i morbiditetit në Kujdesin Dytësor Shëndetësor – spitalet rajonale
- Raporti i lindjeve -nga institucionet shëndetësore publike dhe private 2023
- Raporti për vizitat mjekësore për periudhën Janar- Dhjetor 2023 në KPSH
- Raporti për insulin-vartësit në KPSH për periudhën Janar- Dhjetor 2023 në KPSH
- Raporti i morbiditetit në Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH)
- Raporti për Burimet njerëzore dhe aktivitetet e laboratorit mikrobiologjik në IKSHPK dhe ISHP rajonale, periudha Janar-Dhjetor 2023
- Raporti i punës së QLT në IKSHPK dhe ISHP rajonale, periudha Janar-Dhjetor 2023
- Raporti për Burimet njerëzore dhe aktiviteti i laboratorit të Ekologjisë Humane në IKSHPK dhe ISHP rajonale, periudha Janar-Dhjetor 2023
- Raporti i sëmundjeve malinje për periudhën Janar-Dhjetor 2023

- Raporti i sëmundjeve kronike masovike jo ngjitëse për periudhën Janar-Dhjetor 2023

2.6.2 Aktivitet tjera:

- Mbajtja e trajnimit për Profesionistët e Kujdesit Dytësor dhe Tretësor Shëndetësor për Raportimin e Sëmundjeve Kronike Jongjitëse në Kosovë
- Vizita të rregullta të 11 Institucioneve shëndetësore publike (Klinia e gjinekologjisë, Klinika e psikiatrisë, Institutet Paraklinike, Transfuzion, Klinika e alergologjisë, Administrata e QKUK, Spitali i përgjithshëm Pejë, si dhe QKMF Prishtinë, Lipjan, Pejë dhe Podujevë) dhe 11 institucioneve shëndetësore private (Olive, Klinika Amerikane Dr. Kusari, Spitali Lindja, Spitali Fati im, Spitali Medical Park Kosova, Spitali i përgjithshëm Rezonanca, Spitali Kestrina, Spitali Bahceci në Prishtinë si dhe Poliklinika Ndriçimi RM, Poliklinika Omega dhe Poliklinika Avicena në Pejë), lidhur me përmirësimin e raportimit të të dhënave shëndetësore në IKSHPK.
- Takime të rregullta mujore me Koordinatorët Rajonal të SISH.
- Pjesëmarrje në punëtorinë e Bordit Nacional për Kontrollë të Kancerit 15-16/02/2024
- Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët për Kancerin e qafës së mitrës 26.01.2024
- Kryesuese e grupit për Përpilimin e Fletëparaqitjes për Aborte (Janar, Shkurt)
- Pjesëmarrje në grupin për ngjarjen e lindjes me përfaqësuesit e zyrës së Kryeministrit dhe kompanisë për implementimin e fletëparaqitjes së lindjes
- Pjesëmarrje në grupin punues për Termat e Referencës (ToR) për matjen e kënaqshmërisë së pacientëve me shërbimet shëndetësore në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor.
- Pjesëmarrje në grupin punues për hartimin e Planit të veprimit për përgatitjen dhe funksionalizimin e skemës së barnave jashtë spitalore.
- Pjesëmarrje në takim për - Projekt Udhëzimi Administrativ ruajtja dhe mbrojtja e të dhënave personale për rastet e dyshimta, të mundshme dhe të konfirmuara nga sëmundjet ngjitëse.
- Pjesëmarrje në takim për Hartimin/përditësimin e Klasifikimeve Ndërkombëtare të Sëmundjeve dhe Procedurave ICD11.
- Pjesëmarrje në takimin e Bordit për parandalimin dhe kontrollin e kancerit 04/2024
- Revidimi i artikullit për publikim në Influenca and other respiratory viruses IF 4.3 (artikulli është publikuar).
- Pjesëmarrje në Takim në MPB për Planin e Veprimit të Strategjisë Shtetërore Kundër Drogave.
- Pjesëmarrje në takim në Ministri të Shëndetësisë me përfaqësues të Sistemit Informativ Shëndetësor të MSh-së, dhe përfaqësues të MPB për të diskutuar formën e raportimit që duhet të raportohet në EMCDDA/EUDA.
- Pjesëmarrja dhe prezantimi i punimeve në Konferencën ndërkombëtare të IUHPE në Lodz të Polonisë;
- Pjesëmarrje në takimin Online Projekt Cervix Screening/ MoH
- Mbledhjet e rregullta të Këshillit Profesional të IKSHPK
- Pjesëmarrja online në takimin e TDI/ Treatment -17.10.2024
- Takimi me përfaqësuesit e AQH lidhur me vazhdimin e bashkëpunimit 17.10.2024 ora 14:00 në IKSHPK salla 18.
- Pjesëmarrje në takim në IKSHPK me përfaqësuesit e MPB për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Shtetërore Kundër Drogave-22.10.2024

- Pjesëmarrje në Takim në MSH për mbështetjen dhe bashkëpunimin e MSH-së dhe MPB-së që dalin nga Plani i Veprimit të Strategjisë Shtetërore Kundër Drogave-25.10.2024
- Takimi me IHS në zyret e tyre rreth mundësive të bashkëpunimit me Departamentin e SSH lidhur me ngritjen e shkallës së raportimit të statistikave në spitale me 18.10.2024 ora 14:00
- Pjesëmarrje në takim me komisionin për prokurim në IKSHPK-22.10.2024
- Pjesëmarrje në punëtorinë në Istog - Standardizimi i raportimit brenda departamenteve të IKSHPK dhe QRSHP 12.12.-13.12.2024
- Pjesëmarrje në takimin e grupit punues për Krijimin e regjistrit të trajtimit shëndetësor të personave që përdorin drogë në përputhje me protokolet e EUDA/Agjencia e Bashkimit Evropian për Drogat, si dhe evidentimi i të gjitha rasteve të dyshuara nga mbidoza apo rreziku nga mbidoza.23.12.2024
- Pjesëmarrje në takimin e Komitetit për Intelejencën Epidemike 27.12.2024 - Diskutim rreth menaxhimit të virusit të Lijës M.
- Pjesëmarrje në takimin punues dy-ditorë të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe të mbështetur nga Projekti IHS, lidhur me hartimin e Procedurës Standarde të Operimit (PSO) për Monitorimin e Zbatimit të Udhërrëfyesve dhe Protokoleve Klinike.

2.6.3 Përgatitja e të dhënave sipas kërkesës nga MSH/institucionet tjera

- Raporti i Sëmundjeve malinje për vitet 2020-2022, rruga dhe mënyra e raportimit,dhe disa nga sfidat për raportimin e SM në mungesë të SISH elektronik.
- Raporti i Sëmundjeve kronike jongjitëse për vitet 2020-2022, rruga dhe mënyra e raportimit dhe disa nga sfidat për raportimin e SKJ në mungesë të SISH elektronik.
- Përgatitja e të dhënave të dhjetë diagnozave më të shpeshta nga viti 2012 -2022 (nga të gjitha diagnozat) të morbiditetit të raportuara nga Institucionet Shëndetësore Publike të të tre niveleve të kujdesit shëndetësor.
- Përgatitja e të dhënave - Përqindja e rasteve të reja të kancerit të gjirit (C50.0-C50.9) të raportuara nga institucionet publike dhe private në Kosovë për periudhën 2018 – 2023.
- Përgatitja e të dhënave për rastet e reja dhe të të gjitha rasteve të kancerit të mushkërive (C34-C34.9) dhe mesoteliomës (C45-C45.9) të raportuara nga institucionet publike dhe private në Kosovë për periudhën 2021 – 2023.
- Përgatitja e të dhënave - Përqindja e rasteve të reja dhe total rasteve të kancerit të gjirit (C50.0-C50.9) të raportuara nga institucionet publike dhe private në Kosovë për Komunën e Mitrovicës për vitin 2023.
- Përgatitja e Raporteve vjetore për ueb-faqe të IKSHPK.
- Përgatitja e Raporteve vjetore për ASK.
- Përgatitja e të dhënave - për diabetin e varur (E10) dhe të pavarur nga insulina (E11) për vitin 2022.
- Përgatitja e të dhënave - për diabetin e varur (E10) dhe të pavarur nga insulina (E11) te fëmijët prej 0-18 vjeç për vitin 2022.
- Përgatitja e të dhënave - Rastet e Narkomanisë (F10-F19) nga anekset e Morbiditetit si diagnoza nga QKUK për vitin 2023 dhe Fletëparaqitja e Sëmundjeve masovike jongjitëse për vitin 2023
- Përgatitja e të dhënave - Rastet e reja dhe total rastet e kancereve të komunës së Obiliqit 2020-2023.

- Përgatitja e të dhënave për lindjet nën moshën 14 vjet dhe 14 - 19 vjet nga ASK për 5 vite.
- Përgatitja e vjetarëve statistikor për arhivim.
- Dërgimi i vjetarëve statistikor të planifikuar për webfaqe.
- Kodifikimi i shkaqeve të Vdekjeve për vitin 2023 në Formularët statistikor për vdekje, DEM-2 - Kontrolla logjike dhe vendosja e kodit –shkakut të vdekjes ICD-10 sipas diagnozave të analizuar dhe të raportuara në Fletëparaqitjen e Vdekjeve DEM2 për vitin 2023, 07.12.2024 (Kujdestari)

2.7 Departamenti i Buxhetit dhe Financave

Gjatë periudhës raportuese buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike, IKSHPK ka barazuar gjendjen fizike me 20.01.2025 me atë elektronike të transaksioneve për vitin 2024. Sipas kategorive ekonomike është bërë raportimi i pasqyrës së preformancës financiare. Buxheti i Vitit 2024 nuk ka patur dallim të dukshëm nga buxheti i vitit 2023, situata ka qenë e qetë pa variacione.

Të arriturat kyçe:

- Është realizuar buxheti i vitit fiskal 2024 në vlerë prej 94.99%
- Donacionet krahasuar me vitin paraprak kanë pasur një rritje të dukshme
- Janë blerë 10 veturat nga projekti kapital i realizuar përmes BKK
- Siç shifet nga raportet kemi pasur një rritje gjithsej të të hyrave të mbledhura krahasuar me vitin paraprak fiskal (Tab.6).

Tabela 6 Të hyrat vetanake të mbledhura gjatë Vitit 2024 krahasuar me vitin 2023

Nr.	Emërtimi	Vlera në €	
		2024	2023
1	Të hyrat nga inspektimet higjieniko-sanitare	737,619.99	704,343.51
2	Të hyrat nga participimi	173,794.50	183,291.00
Gjithsej		911,414.49	887,634.51

Në pjesën e mëposhtme janë të pasqyruara shifrat e shpenzimeve sipas kategorive buxhetore dhe krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për IKSHPK (tab.7).

Tabela 7. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për IKSHPK, 2024

Shënim	2024	2023	2022	
	Llogaria e vetme e Th BKK '000	Llogaria e vetme e Th BKK '000	Llogaria e vetme e Th BKK '000	
BURIMET E FONDEVE -PRANIMET				
Granti qeveritar	4980.382	4370.381	3912.207	
Të hyrat vetanake				
Të hyrat e dedikuara				
Grantet e përcaktuara të donatorëve	270.4203	234.5814	181.0491	
Financimet nga huamarrja		18.77319	208.9281	
Klauzola e investimeve				
Të hyrat nga AKP				
Fondi zhvillimor në mirëbesim				
Pranimet tjera				
Gjithsej	5250.803	0 4623.736	0 4302.184	
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT				
Operacionet				
Paga dhe shitesa	2	3475.911	3168.39	2772.114
Mallra dhe shërbime	3	1404.56	1034.745	1019.254
Shpenzime komunale	4	140.6812	130	125.4852
		5021.153	4333.136	3916.853
Transferet				
Transfere dhe subvenci	5			
Shpenzime kapitale				
Prona, ndërtesa dhe paj	6	229.65	290.6	385.3314
Pagesa tjera	7			
Gjithsej	5250.803	4623.736		4302.184

2.8 Departamenti i Administratës

Departamenti i Administratës gjatë vitit 2024 ka kryer këto aktivitete:

2.8.1 Të përgjithshme

- Menaxhimi, koordinimi dhe ofrimi i shërbimeve administrative për të gjitha njësitë dhe organet në kuadër të IKSHPK dhe QRSHP.
- Menaxhimi i të dhënave, dokumenteve dhe arkivit të IKSHPK, korrespondencës zyrtare, dokumenteve dhe të dhënave të tjera të rëndësishme administrative,
- Mbikëqyrja e mirëmbajtjes, riparimit dhe shfrytëzimit të objekteve të IKSHPK/QRSHP, përfshirë sigurimin që objektet të mirëmbahen sipas procedurave të përcaktuara,
- Sigurimi i zbatimit të procedurave për menaxhim e automjetet, mirëmbajtjen dhe servisimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

2.8.2 Logjistika/depo

- Ofrimi i shërbimeve administrative logjistike për të gjitha njësitë dhe organet në kuadër të IKSHPK
- Menaxhimi i depos dhe furnizimeve me materiale, inventar dhe pajisjeve të nevojshme për administratën e IKSHPK si dhe mbikëqyrja e stokut;

- Menaxhimi i nevojave të transportit, ndërmarrja e kontrollave periodik me qëllim të verifikimit të zbatimit të legjislacionit për përdorim të automjeteve zyrtare;
- Faturat e bëra sipas kërkesës së aprovuar për ngarkim për IKSHPK dhe QRSHP janë:
 - o 45 fatura hyrëse të kontratave të rregullta
 - o 5 fatura hyrëse nga Donacionet, dhe
 - o 546 fatura dalëse.

2.8.3 Teknologjia informative

Gjatë vitit 2024, sektori i Teknologjisë Informative ka realizuar një sërë projektesh dhe aktivitete që kanë kontribuar në përmirësimin e proceseve të punës, automatizimin e shërbimeve dhe modernizimin e infrastrukturës teknologjike. Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Përmirësimi i Infrastrukturës së teknologjisë informative
- Mbështetja Teknike
- Menaxhimi i Pajisjeve
- Menaxhimi i softuerëve dhe Aplikacioneve
- Administrimi i Rrjetit
- Siguria e Sistemeve dhe të Dhënave
- Trajnimi i Përdoruesve

2.8.4 Divizioni i Personelit

Divizioni i Personelit gjatë vitit 2024 ka vazhduar me përkrahjen e të gjitha proceseve në lidhje me rekrutim, punësim, trajnim, pensionim të personelit. Aktivitetet përfshijnë:

- Përgatitja e planit të Personelit, definimin e vendeve të punës dhe pozitat e lira.
- Ndihmë teknike për procesin e vlerësimit të rezultateve në punë si përgatitja e formularëve të planit të punës, shpërndarja e tyre dhe arkivimi.
- Ndihmë teknike në përgatitjen e draft planit për trajnime të stafit në bazë të detyrave dhe përgjegjësi të punës.
- Përcjellja e legjislacionit në fuqi, shkresat përcjellëse në Ministri të Drejtësisë dhe raportet periodike në Departamentin Ligjor të MSH-së
- Hartimi i raporteve në lidhje me burimet njerëzore të IKSHPK-së.
- Ndihmë dhe këshillim i menaxhmentit, paneleve rekrutuese lidhur me praktikën e drejta të punësimit bazuar në ligje dhe akte tjera nënligjore.
- Inicimi, menaxhimi dhe përfundimi i procedurave të rekrutimit dhe punësimit të stafit
- Përgatitja e listave për hyrje-dalje nga puna.
- Mbajtja e shënimeve për mungesa, pushime vjetore dhe mjekësore, pushime të lehonisë dhe pushime pa pagesë, daljet në pensionim, vonesa dhe arkivimi i listave.
- Përcjellja në formë elektronike e Vijueshmerisë në Punë në Program elektronik dhe nxjerrja e raporteve periodike për vijueshmërinë në punë.
- Pranimi i Listave të Pagave nga ana e Ministrisë në mënyrën elektronike.
- Kalkulimi i Shujtave dhe Kujdestarive për IKSHPK-në, përcjelljen në Ministri të Financave dhe arkivimi i tyre
- Raportimin Periodik për Personelin e IKSHPK-së në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Departament për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (procedimi bëhet në çdo muaj)
- Krijimi i dosjes për punëtor të rinj
- Azhurimi i dosjeve në formë fizike me të dhëna dhe dokumente të reja.

- Azhurimi i dosjeve në formë elektronike me të dhëna të reja (databazën elektronike të IKSHPK-së) gjatë gjithë vitit. Regjistrimi dhe evidentimi për trajnimet e ndjekura të stafit.
- Përgaditja e seancave dhe mbajtja e procesverbaleve për komisionet.
- Ofrimi i dëshmimeve për anëtarët e komisioneve dhe palët e përfshira.
- Dorëzimi dhe komunikimi i vendimeve për palët e përfshira.
- Janë punësuar dy (2) Mjek Specialist, shtatë (7) Infermierë/laborantë, tre (3) Pastrues,
- Shtatë (7) punëtorë janë pensionuar.
- Katër (4) punëtore janë në pushim të lehonise në vitin 2024, dhe dy vazhdojnë pushimin në vitin 2025.

2.9 Divizioni i Prokurimit

Divizioni i Prokurimit gjatë vitit 2024 ka iniciuar 24 aktivitete të prokurimit për IKSHPK. Nga 24 aktivitete, 2 janë në ankimim dhe 1 lot i 1 aktiviteti është anuluar në mungesë të tenderuesve, ndërsa 22 prej tyre janë përmbyllur me nënshkrim të kontratave:

- Përgaditja e paramasës dhe paralogarisë për punë
- Shërbime të mirëmbajtjes së objektit - QRSHP Mitrovicë, ritenderim
- Furnizim me pajisje TI
- Zhvillimi dhe dizajnimi i Web faqes së IKSHPK
- Servisimi dhe kalibrimi i pajisjeve VIKAM series EX-4, Vidas, Tempo dhe IDEX me aksesore, Servisimi dhe mirëmbajtja e ArisHiq sensitiv
- Funkcionalizimi i rrjetit telefonik VoIP në të gjitha qendrat rajonale dhe IKSHPK
- Shërbime të printimit të librezave sanitare
- Furnizim me pajisje e makineri të ndryshme
- Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve
- Sigurimi fizik i objekteve
- Furnizim me pajisje TI që nuk janë përfshirë në kontratat e centralizuara të AQP
- Furnizim me karrige për artikujt që nuk janë të përfshirë në kontratat e AQP
- Shërbime të mirëmbajtjes së objekteve
- Furnizim me material zyrtar
- Lot 2 – Servisimi dhe mirëmbajtja e Analizatorit XL Liason. Lot 5 - Mirëmbajtja parandaluese për MiSeq Illumina, Lot 3 – Servisimi dhe mirëmbajtja e RT PCR Bio-Rad CFX96 Dx, Lot 4 - Servisimi dhe mirëmbajtja e Nextractor 48, Genolution, Lot 8 – Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve iCAP 7400 Duo ICP-OES, GC 2010 dhe Behtotest Infrared Kjeldahl Inkjel 625P
- Lot 1- Furnizim me inventar dhe Lot 2- Furnizim me perde
- Shërbime të mbikqyerjes së punëve të riparimit dhe mirëmbajtjes së objekteve
- Punët e riparimit dhe mirëmbajtjes së objekteve
- Lot - Servisimi dhe mirëmbajtja e Vitek MS, Lot - Servisimi dhe mirëmbajtja e VITEK COMPACT 2, BactAlert Instrument, Previcolour, AUTOMAT POURER APS ONE dhe MASTERCLAVE 20
- Furnizim me gas për aplikim në pajisje laboratorike

- Lot 1- riparimi dhe mirembajtja e kamerave, Lot 2 – riparimi dhe mirëmbajtja e laurave (anuluar)
- Furnizim me reagjent (27 lote)

2.10 Qendra për Udhërrëfyes dhe Protokole Klinike, Performancën e sistemit Shëndetësor dhe Satisfaksionin e Pacientëve

Qendra për Udhërrëfyesit dhe Protokollet Klinike (UPK), Performancën e sistemit Shëndetësor dhe Satisfaksionin e Pacientëve ka kontribuar në fascilitimin e procesit të adaptimit të Udhërrëfyesve Klinike dhe hartimit të Protokoleve Klinike, si komponentë të rëndësishme për standardizimin e kujdesit shëndetësor, përmirësimin e rezultateve të pacientit, sigurinë në kujdesin shëndetësor dhe përgjegjësinë ligjore dhe etike në kujdesin shëndetësor. Qendra për UPK ka kryer këto aktivitete:

- Është bërë themelimi i Sekretarisë me vendimin e Ministrit me nr.05-424 të datës 25.01.2024 në kuadër të Qendrës për UPK
- Takimi me Këshillin Kosovar për UPK-në (KKUPK)
- Takimi me ekspertin Mihai Horga për UPK
- Pjesëmarrja në takimin - Tryeza e Rrumbullakët për Diabet
- Pjesëmarrja në punëtorinë për Aprovimin e rregullores së punës të KKUPK-së
- Mbledhjet mujore me kryesuesit e GP për adaptimin e udhërrëfyesve dhe protokoleve klinike
- Trajnimi për metodologjinë e adaptimit/hartimit të udhërrëfyesve dhe protokoleve klinike
- Trajnimi i Trajnerëve (28/29/30/31 Tetor.24) për adaptimin e UPK-ve
- Realizimi i hulumtimit mbi kënaqshmërinë në vendin e punës në IKSHPK
- Ekspertizë profesionale lidhur me hulumtimet në fushën e shëndetit Publik - Përpilimi i termave të referencës për hulumtimin mbi satisfaksionin e pacientëve në kuadër të grupi punues
- Analiza e performancës së spitaleve rajonale
- Pjesëmarrja në punëtorinë për aprovimin e doracakut për metodologjinë e zhvillimit të udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike
- Pjesëmarrja në punëtorinë për PSO për UPK
- Fascilitimi i 63 Udhërrëfyes Klinikë dhe 8 Protokole Klinike
- Pjesëmarrja në grupin punues për hartimin “Udhëzues për monitorimin e zhvillimit të fëmijëve 0-6 vjeç në Kujdesin Parësor Shëndetësor”
- Përkrahja e vazhdueshme ndaj grupeve punuese për procesin e adaptimit të Udhërrëfyesve Klinikë dhe hartimit të Protokoleve Klinike
- Realizimi dhe raportimi i hulumtimit mbi satisfaksionin e pacientëve
- Hulumtimi vjetor lidhur me cilësinë e kujdesit shëndetësor në IKSHPK.
- trajnime dhe ekspertizë profesionale në kuadër të Programit Vizitat në Shtëpi
- 1 prej 4 Master Trajnerëve për trajnimet “Udhëzuesi për Monitorimin e Zhvillueshmërisë së Fëmijëve” për monitorimin e zhvillimit të fëmijëve në kuadër të programit Vizitat në Shtëpi,

- Pjesëmarrja në Trajnimin Regjional të Master Trajnerëve për përkrahjen e familjeve për kujdesin gjithëpërfshirës për vizitorët e shtëpisë- Budapest. 18 – 22. 11. 2024 për fuqizimin e programit Vizitat në shtëpi në kuadër të KPSH-së.
- Trajnimet e mbajtura në kuadër të Programit “Vizitat Shtëpiake” -GMCD.
- Pjesëmarrja në punëtori lidhur me studimin kohort për sëmundjet jo-ngjitëse në Kosovë (KOSCO) Bazel/ Zvicër, 20-22 maj 2024
- Trajnimi Statistika përmes SPSS dhe GIS, 6-9, 13-14, 20-21 Dhjetor, 2024
- Koordinimi i procesit të hartimit të raporteve të Planit të Performancës për IKSHPK 2025 dhe Raportit të Performancës për IKSHPK 2024

2.11 Qendra e Moshimit

Qendra e moshimit gjatë vitit 2024 ka kryer aktivitete për promovimin e shëndetit të të moshuarve në Kosovë përmes avokimit, trajnimeve, aktiviteteve konkrete, hulumtimeve, krjimit dhe shpërndarjes së materialit promovues shëndetësor, etj.

2.11.1 Moshimi

- Organizimi dhe realizimi i trajnimeve për mjekët dhe infermierët e KPSH-së, KDSH-së, QRSHP, IKSHPK dhe Trajnim i Trajnerëve me temën “Kujdesi ndaj pacientëve të moshuar”, si dhe aplikimi në Odën e Mjekëve të Kosovës dhe Odën e Infermierëve të Kosovës për akreditim të këtij trajnimi.
- Takimi Mjekësia e stilit jetësor me përfaqësuesit e KOMS-it
- Realizimi i hulumtimit dhe regjistrimi i të dhënave në databazën për Health Literacy
- Takimi me AQH për modalitetet e transferit institucional të pakos së trajnimeve, përkatësisht modulit të “Kujdesit ndaj të moshuarve”
- Takim me përfaqësuesen e Vita jeta për aktivitetet e përbashkëta me të moshuarit në vitin 2024
- Takim me përfaqësues të organizatave të të moshuarve –për perzgjedhjen e fotove dhe mesazheve për publikim, për të shënuar 1 Tetorin, ditën e të moshuarve
- Përgatitja e mesazheve “Përvoja dhe kontributi ynë ka vlerë: Ndërtojmë komunitete të forta së bashku” për postim në rrjetet sociale të IKSHPK-se
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Personave të Moshuar
- Shpërndarja e posterit “Përvoja dhe kontributi ynë ka vlerë: Ndërtojmë komunitete të forta së bashku” dhe materialeve edukuese dhe promovuese
- Trajnimi ToT i personelit të kujdesit shëndetësor (infermierë) për edukimin dhe trajnimin e kujdestarëve informalë në kujdesin në shtëpi të të moshuarve”
- Përgatitja e Abstraktit “Gjendja e të Moshuarve në Kosovë: Sfidat dhe Mundësitë”
- Analiza e të dhënave për Sëmundjet Kronike jo ngjitëse tek të moshuarit dhe Sëmundjeve Malinje tek të moshuarit për prezantim në konferencë
- Takime dhe punëtori me grupin punues për plotësim të programit specialistik për mjekësi familjare për modulën kujdesi ndaj personave të moshuar dhe kujdesi paliativ
- Pjesëmarrja në Emisionin Radar në radio Dukagjini lidhur me Rekomandimet për të moshuarit gjatë temperaturave të larta

- Kordinimi i realizimit të hulumtimit “Zbulimi i nevojave të paplotësuara të kujdesit shëndetësor në mesin e të moshuarve në Prishtinë” në të gjitha Qendrat për persona të moshuar në komunën e Prishtinës
- Pjesëmarrja në Aktivitetin fizik për të moshuarit në Blinajë, Lipjan me ligjeratën në temën “Të drejtat e të moshuarve në kujdesin shëndetësor”
- Ligjërata me pacientë në QKMF Lipjan me temën “Sëmundjet kronike tek të moshuarit në Kosovë”
- Ligjërata në OJQ “Vita Jeta” me mbi 20 gra, me temën “Diabeti tek të moshuarit
- Vizitë në OJQ Pojata dhe OJQ Vita Jeta për realizimin e hulumtimit “Zbulimi i nevojave të paplotësuara të kujdesit shëndetësor në mesin e të moshuarve në Prishtinë”
- Përgaditja për hulumtimin “ Zbulimi i nevojave të paplotësuara të kujdesit shëndetësor në mesin e të moshuarve në Prishtinë”.
- Përgaditja e dokumentit si përgjigje për plotësim të rekomandimeve në kërkesën e Avokatit të Popullit për shëndetin mendor të të moshuarve
- Distribrimi i materialeve edukativo - shëndetësore me tematikë të ndryshme për të moshuarit
- Ligjërata në OJQ “Pojata” me mbi 20 gra, me temën “Diabeti tek të moshuarit”

2.11.2 Aktivitete tjera

- Pjesëmarrja në konferencën “Gjendja e të Moshuarve në Ballkan dhe Evropën Lindore: Sfidat dhe Mundësitë”, Tiranë, 31 tetor 2024 me prezantim “Gjendja e të Moshuarve në Kosovë: Sfidat dhe Mundësitë”
- Pjesëmarrja në tryezën e rrumbullakët –“Java e ndërgjegjësimit për skringing të kancerit të qafes së mitrës”
- Pjesëmarrja në “Simpoziumin e parë për glaukomë”
- Pjesëmarrja në shënimin e ditës botërore të shëndetit me moton “Shëndeti im, e drejta ime”
- Pjesëmarrja në lansimin e Indeksit të Plakjes Aktive në Kosovë
- Pjesëmarrje në punëtori lidhur me studimin kohort për sëmundjet jo-ngjitëse në Kosovë (KOSKO) në Bazel, Zvicër
- Pjesëmarrje në trajnim “Intervistimi dhe këshillimi motivues”
- Pjesëmarrje në trajnim për metodologjinë e hartimit të udhërrëfyesve dhe protokoleve klinike
- Pjesëmarrje në takimin e hulumtimit “Kohorta e Sëmundjeve Jo-ngjitëse të Kosovës (KOSCO)”
- Takimi në video call lidhur me Kujdesin e integruar dixhital

2.12 Komunikimi me publikun

Kjo pjesë përmbledhë aktivitetet e komunikimit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës lidhur me publikimet, përgjigjet për media dhe postimet në platformat e ndryshme të komunikimit, duke përfshirë faqen zyrtare të institutit dhe rrjetet sociale. Aktivitetet e ueb-faqes janë të dokumentuara pas datës 1 shtator 2024, kur është lansuar faqja e re e IKSHPK.

Aktivitetet e komunikimit me publikun janë:

- Në faqen zyrtare të IKSHPK-së janë publikuar gjithsej 106 materiale që mbulojnë tema të ndryshme shëndetësore dhe informuese.
- Në Facebook janë bërë 20 komunikata, 202 postime, 6 infografika dhe 6 video mesazhe për të informuar dhe sensibilizuar publikun për çështje të rëndësishme shëndetësore.
- Janë realizuar gjithsej 383 përgjigje për mediat e shkruara dhe elektronike, duke kontribuar në informimin e saktë dhe të qartë të publikut.
- Janë realizuar 33 intervista të drejtpërdrejta dhe të përgatitura në media.
- Ka patur 0 kërkesa për qasje në dokumente publike për vitin 2024.

2.13 Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik

Aktivitetet kryesore të Qendrave Rajonale të Shëndetit Publik janë përfshirë në raportimet e departamenteve përkatëse të IKSHPK-së.

2.14 Aktivitete tjera

IKSHPK ka vazhduar aktivitetin arsimor, me studime paradiplomike dhe pasdiplomike, ndërsa stafi jonë ka kontribuar që të ri-akreditohet programi i doktoratës në Shëndetësi Publike. Po ashtu, 2 epidemiologë dhe 1 specialist i shëndetësisë publike kanë marrë përgjegjësi të Dekanit dhe Prodekanit në Fakultetin e Mjekësisë gjegjësisht Prorektorit për çështje arsimore në Universitetin e Prishtinës.

Është rifreskuar autoparku me 10 vetura të blera dhe 5 vetura të marrura në përdorim, që kontribuon në veçanti në mbikëqyrjen epidemiologjike dhe mikrobiologjike në terren, si dhe në sigurinë e të punësuarve gjatë punës në terren.

Sa i përket sigurisë dhe shëndetit në punë, IKSHPK ka dërguar katër persona për tu trajnuar në këtë lëmi, me qëllim të fitimit të statusit të ekspertit për siguri dhe shëndet në punë, si dhe për të zhvilluar aktivitetet e sigurisë dhe shëndetit në punë të parapara me legjislacionin në fuqi

3. Sfidat në realizimin e detyrave

Gjatë vitit 2024 IKSHPK është ballafaquar me sfida të ndryshme të cilat drejtpërdrejtë apo tërthorazi kanë ndikuar në vonesa në kryerjen e aktiviteteve të punës, ngarkesë të panevojshme të stafit si dhe ndonjëherë edhe në cilësi të ulur të punës. Ndër to vlen të theksohen:

- Mungesa e Strategjisë Sektoriale Shëndetësore (e cila u miratua në fundvit);
- Nevoja për përditësim të Statutit të IKSHPK-së (realizuar)
- Mungesa e Rregullores për organizimin e brendshëm për sistematizimin e vendeve të punës në IKSHPK (miratuar në fundvit)
- Vonesat në vendimmarrje nga OSHP që ka ndikuar zbatimin e 2 aktiviteteve të prokurimit.
- Mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për blerjen e kiteve dhe materialit harxhues laboratorik për të mbuluar kërkesat e qytetarëve të Kosovës për shërbime mikrobiologjike
- Buxheti i ulët për mirëmbajtje të aparaturave të mikrobiologjisë
- Buxheti i ulët për zhvillim profesional të stafit
- Mungesa e buxhetit të veçantë për realizimin e aktiviteteve të parapara në Planet e ndryshme të Veprimtari ku i caktohen përgjegjësi IKSHPK-së
- Mungesa e kuadrit për të mbuluar realizimin e të gjitha aktiviteteve si pasojë e largimit dhe pensionimit
- Moshimi i kuadrit dhe nevoja për përtëritje të tij
- Numri i pamjaftueshëm i pozitave të alokuara për IKSHPK (306)
- Problemet me pajisje të punës, si psh. mosfunksionimet me muaj të printerëve ose skadimi i licencave të kompjuterëve, kanë qenë probleme të shpeshta.
- Objekti i vjetëruar në Prishtinë, që ka rezultuar me rrjedhje të ujit në disa vende, nga një kat në tjetrin, dhe është shfaqur nevoja për riparime emergjente
- Hapësirat jo mirë të shfrytëzuara, por edhe mungesë e tyre, me që aktivitetet po shtohen
- Nevojat për riparime në objekte në QRSHP, shumica e të cilave janë relativisht të reja.
- Mungesa e të dhënave me kohë nga institucionet relevante dhe veçanërisht nga ASK
- Mosshfrytëzimi i sistemit digjital të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse SMSN dhe raportimi i rasteve kryesisht në formë manuale.
- Pengesat në grumbulimin dhe përpunimin e statistikave shëndetësore
- Ngarkesa administrative me përpilim të raporteve të rregullta të punës, planeve të punës por edhe raportimeve tjera të kërkuara nga institucionet e ndryshme përmes MSH-së.

4. Planet për vitin e ardhshëm

IKSHPK ka të hartuar planin e punës për vitin 2025, i cili bazohet në legjislacionin përkatës dhe dokumentet strategjike përfshirë Strategjinë Sektoriale Shëndetësore 2025-2030 dhe planet e veprimit që rrjedhin nga kjo strategji.

Përpos aktiviteteve të parapara në planin e punës për vitin 2025, aktivitetet e rregullta të IKSHPK të cilat do të vazhdojnë të kryhen edhe në vitin 2025 përfshijnë mbikëqyrjen e situatës epidemiologjike, identifikimi i faktorëve të sëmundjeve, vaksinimi sipas kalendarit të rregullt, kontrollat sanitare të personelit në industri shërbyese, mbikëqyrja e kushteve higjieniko-sanitare në institucione të veçanta, mbikëqyrja e cilësisë së ujit, ngritja e vazhdueshme e cilësisë së punës në laboratorët e IKSHPK, edukimi dhe promovimi shëndetësor, vlerësimi i situatës së grupeve të veçanta të popullatës, prodhimi i vjetarëve statistikor, pjesëmarrja në hartimin e akteve juridike dhe dokumenteve strategjike, këshillimi i bazuar në evidenca për politikëbërje sipas kërkesës, arsimimi universitar dhe pasuniversitar në shkencat e mjekësisë, zhvillimi i vazhdueshëm profesional i stafit, hulumtime shkencore (STEPS, GYTS etj), bashkëpunimi me institucione relevante, komunikimi i rregullt me publikun dhe zëvendësimi i kuadrit të pensionuar.

Ativitete tjera të parapara janë zbatimi i Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IKSHPK (psh. Avokimi për shtimin e numrit të të punësuarve nga 306 në 346 sa parashihen me rregullore, inicimi i punës së QRSHP Prishtinë, shkrija e 4 departamenteve në 2, krijimi i divizioneve të reja, sistematizimi i punëtorëve, etj), kontrolli sistematik i të punësuarve, vlerësimi i sigurisë dhe shëndetit në punë, fillimi i procedurave për krijimin e regjistrit elektronik të kancerit, përkthimi i Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve versioni 11,